



D R I T A

“Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon.”

KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Tetor 2009 • Viti XXVI • Nr. 10 (180) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3SFR, SHBA \$2.50



10 vite balancë të emergjencës, rindërtimit dhe punës zhvillimore
FAQE 4

Përgatitën:
V. MINCI & G. MEILI



Nëna Tereze dhe shqiptarët

FAQE 14

Shkruan:
NDUE UKAJ



Zgjedhja e thirrjes - përcaktim për një jetë më të mirë

FAQE 18

Shkruan:
M. HANA KQIRA



Zgjedhjet – detyrë, mundësi dhe përgjegjësi qytetare dhe morale

Mons. Dodë Gjergji, ipeshkëv

Jemi në jehonë të fushatës parazgjedhore me shumë takime, fjalime, paraqitje, premtime... Njeriu i rëndomtë shpesh e pyet vetveten, e, aty-këtu, edhe të tjerët: çka na nevojitet gjithë kjo zhurmë, këto lëvizje, harxhime, tolloni? Edhe ashtu nuk ndërrohet asgjë, ose shumë pak... Madje, ndryshimi është shpesh në dobi të atyre që e kanë “pushtetin”, që janë me “shpinë të fortë”, të pasur, të privilegjuar, ndërsa shumica, shtresat popullore, vazhdojnë me të “vjetërën”, me papunësi, varfëri, moskujdes, nënçmim, deri edhe të lodhja, rraskapitja, mos të them mërzia dhe dëshpërimi që krijojnë një lloj “apatie” apo indiferentizmi politik dhe kulturor.

Megjithatë, zgjedhjet janë pikësëpari një detyrë qytetare, morale dhe kombëtare për të gjithë, sepse vetëm kështu mund dhe duhet të gjithë të jemi pjesëmarrës në jetën politike, ekonomike, kulturore, shoqërore... Mirëpo, menjëherë shtrohet pyetja: sa ne e kemi përgatitur dhe aftësuar popullin, njeriun tonë të thjeshtë dhe të rëndomtë për këtë detyrë, si dhe për shumë detyra tjera në tri nivele: personale, familjare dhe shoqërore, pa të cilat nuk ka demokraci të mirëfilltë, pra, as liri, bashkëpunim dhe bashkëjetesë.

Demokracia është një mundësi e madhe, e rëndësishme, vendimprurëse për çdo qytetar, pa përjashtime dhe anashkalime, pa mashtrime dhe manipulime, pa dredhi dhe kushhtëzime... Kjo mundësi teorike, shpesh nuk është edhe praktike, sepse tashmë popullata është e “ngopur” nga shumë premtime dhe pak zbatime, prandaj nuk di më për kë të votohet, përse dhe si, sepse “muzika është gjithnjë e vjetër”, me ndonjë fjalë, apo fytyrë të re! Në skenën tonë politike pak ka njerëz që vërtet angazhohen për zhvillimin dhe përparimin e njeriut, për edukimin e fëmijëve dhe të rinjve, për një familje të shëndoshë dhe të bashkuar, për të varfër dhe të vetmuar, e mos të flasin për pensionistë, pleq dhe plaka, të cilët trajtohen si “lënde” apo barrë e shoqërisë sonë!

Mundësia e këtyre zgjidhjeve është për të gjithë ne tejet e rëndësishme, sepse për herë të parë i organizojmë në Kosovën tonë të lirë dhe demokratike si Shtet i pavarur, pjesërisht i njohur dhe i pranuar nga një numër i shteteve të rëndësishme ndërkombëtare. Rëndësi ka, pra, që fushata parazgjedhore, si dhe zgjedhjet, të jenë sa më të mira dhe të lira, ku do të mbizotërojnë vlerat e mirëfillta dhe virtetet tona të lashta dhe të tashme: nderi, sinqeriteti, bisedimi, dialogu, komunikimi, bashkëpunimi dhe bashkëjetesa për të krijuar gjithnjë bashkimin në dallime. E vërteta duhet të përcillet gjithnjë nga nderimi dhe dashuria, përndryshe do të jetë një lojë me mekanizmat e njohur të fajësimit-shfajësimit, pa ndonjë dobi dhe fryt konkret.

Përgjegjësia është një virtut i domosdoshëm për të gjithë, kuptohet sipas vendit, detyrës, mundësive, por gjithnjë në prizmin e shërbimit për të mirën e përbashkët e të gjithëve, me përgjegjësi, bashkëpërgjegjësi, me mekanizma që përplotësohen dhe jetës i japin një kuptim dhe shije të veçantë si bashkësi njerëzore, qytetare, kombëtare, fetare...

Kjo domethënë se politika është në shërbim të njeriut, familjes, shoqërisë, e jo anasjelltas, si dikur, kur ajo sundonte, mbizotëronte, robëronte, shkretonte, shkatërronte... Mos ta harrojmë parimin dhe porosinë thelbore: Jemi të lirë vetëm aq sa jemi edhe të mirë!

Urojmë dhe lusim Zotin që këtë “provim” ta ballafaqojmë dhe kalojmë sa më mirë dhe suksesshëm, për t’ia dëshmuar së pari vetvetes, pastaj edhe të tjerëve, se edhe ne si qytetarë jemi të pjekur, dimë, duam dhe bashkëpunojmë në kërkimin e së mirës së përbashkët!

Familja Albani, katër shekuj shkëlqim historik

FAQE 15

Shkruan:
Prend BUZHALA

Intervistë me regjisorin dhe skenaristin kosovar Gjon Kolëndrekaj

Afrim i qytetërimeve përmes krijimtarisë kinematografike

FAQE 12-13



U kremtua festa e Engjëllit të Rojës në famullinë e Ferizajit



Më 2 tetor 2009 në Ferizaj, në një ambient festiv, i rregulluar enkas për këtë ditë, u kremtua festa e Engjëlli Rojtar. Në praninë shumë besimtarëve meshën solemne e udhëhoqi Mons. Dodë Gjergji me një numër të madh meshtarësh.

Në homilinë e rastit Ipeshkvi ynë ftoi besimtarët që të jetësojnë fjalën e Zotit në raport me të afërmin. Për krejt këtë është e nevojshme ndërmyshësia e Engjëlli Rojtar për ta njohur rrugën drejt Idealit që e kuptimëson këtë jetë plot sfida dhe sprova gjatë përditshmërisë sonë.

Në këtë solemnitet madhështor është përfurur shtëpia prone e kësaj famullie, në të cilin objekt Motrat e Dashurie Hyjnore janë vendosur dhe kryejnë misionin e vetë në shërbim të çdo njeriu vullnet mirë.

Në të njëjtin objekt është

hapur edhe çerdhja e fëmijëve parashkollorë.

Po në këtë ditë solemne është inauguruar edhe aneksi i ri i Caritasit, institucion bamirës.

Këtë festë e zmadhuan shumë mysafirë nga vendet e ndryshme të Evropës, por do theksuar prezencën e Don Sandro Saboleta nga Italia, njëherësh edhe qytetar ndri i qytetit të Ferizajt dhe bamirës i dalluar anekënd Kosovës.

Pas meshës Don Viktor Sopi, famullitar, falënderoi Ipeshkvin e vendit dhe tërë mysafirët, duke e shtruar sofrën vëllazërore për mysafirët e rastit në sallonet e objektit të ri të posa inauguruar.

Ishte një ditë e veçantë për besimtarët dhe për mbar qytetin e Ferizajt.

Në çdo fytyrë u vente gëzimi dhe hareja për këtë dhuratë që e dhuroi Zoti!

(V.S.)

Meshtarët tanë në ushtrime shpirtërore

Me datën 19 - 21 tetor 2009, në Letnicë, meshtarët kanë mbajtur Ushtrimet Shpirtërore, të udhëhequra nga Shkelqësia e Tij, Imzot George Frenko O.P. Ipeshkëvi ndihmës i Tiranës, Ushtrimet Shpirtërore janë mbajtur pikërisht në muajin tetor, muaj ky që i kushtohet Rruzares dhe Misio-neve.

Ligjëratat ishin mbi Vitin Meshtarak, të shpallur nga Papa Benedikti XVI. Ipeshkvi ka paraqitur këtë vit, si vit të veçantë, në të cilin duhet të zbulojmë bukurinë e jetës dhe shërbimit meshtarak. Temat boshite ishin: Meshtari, besnik ndaj Jezu Krishtit si dhe ndaj njeriut të botës së sotme.



Duke falënderuar Zotin, përmes Eukaristisë së Shenjtë, si dhe duke falënderuar bujarinë dhe mikpritjen e famullitarit të Letnicës, Don Kristë Gjergji, përfunduan këto tre ditë, që me të vërtetë ishin ditë të pasura shpirtërisht dhe vëllazërisht. Në Ushtrime Shpirtërore kanë marrë pjesë 16 meshtarë të Dioqezeve sonë.

(Don Albert Jakaj)

Kronikë nga Seminari “Lazër Mjeda” në Prizren

Që nga viti 1994 në Prizrenin tonë të lashtë rihapet Seminari i Ultë “Lazër Mjeda” për të pranuar, ndihmuar, edukuar dhe shkolluar të gjithë ata djem, të cilët në brendësinë e tyre e ndjejnë zërin e Zotit që i thërrret për t’ia kushtuar jetën Atij, duke e shërbyer dhe dashur në vëllain njeri. Tashmë janë dhjetëra meshtarë të rinj, të cilët kaluan nga dyert e Seminarit të Prizrenit, dhe, falë edukimit dhe formimit që pranuan në këtë bashkësi, ia arritën qëllimit të meshtarisë. Seminari i Ultë i Ipeshkëvisë së Kosovës që nga viti 1994 as një herë nuk mbeti i zbrazur, përkundrazi nganjëherë duhej të ‘ngushtohemi’ vetëm e vetëm për të pranuar djemtë e rinj që dëshironin ta ndjekin Zotin në rrugën e meshtarisë, edhe pse jo

ndërrimin e të jetuarit dhe të të menduarit brenda familjes dhe shoqërisë; pikërisht për këtë arsye, ne të rinjtë, kemi nevojë për persona të pjekur, të cilët dinë të na kuptojnë dhe të zbulojnë në ne ato prirje të mira dhe të shenjta që shumë herë e kemi të vështirë t’i nxjerrim në pah vetvetiu, kemi nevojë për persona, të cilët dinë të jenë të durueshëm me ne, për persona, të cilët nuk kanë frikë t’i jetojnë idealat ungjillore dhe ato të na i propozojnë edhe ne.

Të kthehemi në bashkësinë tonë të Seminarit ku jetojmë, formohemi dhe studiojmë me një qëllim të vetëm: “Të kuptojmë planin e Zotit në jetën tonë dhe ta jetojmë atë”. Viti 2009, i kushtuar meshtarisë së shenjtë dhe lutjes për thirrje të shenja, për

kemi hasur në ata persona, të cilët janë të caktuar të jenë përgjegjës për thirrje të shenja në Ipeshkvi.

Që nga viti i kaluar, nga dëshira për të zgjuar në zemrat e të rinjve etjen për Krishtin, eprorët e Seminarit kanë vendosur të promovojnë thirrjet e shenja, duke kaluar nga famullia në famulli, së bashku me ne seminaristët, për të bërë dëshminë e thirrjes. Entuziazmi, afërsia, përkrahja, pyetjet e shumta, kureshtja dhe prania e madhe e të rinjve në takimet e tilla, na bënë të ndjehemi edhe më të fortë në thirrjen dhe në zgjedhjen tonë për një jetë me Krishtin. Dhe, ajo më e bukura, e cila ndodhi, ishte se Zoti menjëherë i preku zemrat e disa të rinjve, sa që menjëherë shprehën dëshirën për të filluar një jetë në bashkësi – në Seminar. Këtë vit



Engjëll Azizi, Gjergj Pera, Daniell Ukaj, Don Anton Ukaj, Nikollë Perizi, Samuell Ramaj, Driton Hajdaraj, Driton Simoni, Nue Cera, Kolë Dedaj, Gentian Krasniqi

g gjithmonë të gjithë ia arrijnë, sepse edhe vetë Jezusi thotë: “Shumë janë të thirrur e pak të zgjedhur”.

Edhe në këto vite të fundit, ku gjithnjë vazhdohej të thuhet se të rinjtë nuk janë të aftë për ta dëgjuar zërin e Zotit dhe nuk dinë t’i përgjigjen Atij, lirisht mund të themi se në Kishën tonë lokale dëshmohej e kundërta. Nuk është e vërtetë se të rinjtë nuk dinë dhe nuk duan ta dëgjojnë Zotin, nuk është e vërtetë se në zemrën e ne të rinjve nuk ekziston dëshira për ta jetuar një jetë tjetër nga ajo që ofron dhe jeton ‘bota’, nuk është e vërtetë se të rinjtë e shekullit XXI nuk dinë dhe nuk dëshirojnë të lusin, nuk është e vërtetë se të rinjtë nuk kanë ideale dhe qëllime të shenja. Por, është e vërtetë që ne, të rinjtë e kësaj kohe, jetojmë në një kohë jo të lehtë për të vendosur dhe për të zgjedhur ‘të mirën’, e kjo ndodh për arsye të shumta që kanë ndikuar në

Kishën tonë në Kosovë vazhdon të jetë një vit i veçantë përplot hire dhe bekime, në këtë vit patëm mundësi ta shohim me sytë tanë dëshminë e gjallë të të rinjve dhe të rejave tona, të cilët vendosën t’ia kushtojnë jetën e tyre Zotit, duke e pranuar jetën e meshtarisë dhe të rregulltarisë. Guximi dhe dëshmia e këtyre të rinjve për ta ndjekur dhe dashur Krishtin më për së afërmi, bëhet edhe për shumë të rinj të tjerë sikur ‘një zjarr që merr flakë ndër ferra’.

Edhe për bashkësinë tonë të Seminarit mund të themi se ky vit ishte i veçantë, sepse hiq më pak se 9 të rinj, nga famulli të ndryshme të Kosovës, dëgjuan, pranuan dhe iu përgjigjen thirrjes së Zotit, duke dëshiruar të fillojnë jetën në Seminar. Në rend të parë, kjo është dhuratë e Zotit që na u bë në dhe Kishës sonë, por nuk dëshirojmë të harrojmë e aq më pak të mohojmë edhe ndihmën dhe përkrahjen që

në Seminarin tonë të Prizrenit kemi 13 seminaristë, tre nga këta tashmë kanë lënë bashkësinë tonë dhe janë vendosur në Seminarin e madh në Shkodër për të vazhduar studimet filozofike-teologjike, ndërsa dhjetë të tjerët vazhdojnë shkollimin dhe formimin tonë këtu në Prizren.

Falënderojmë Zotin për të gjitha huret dhe bekimet që vazhdon t’i zbrazë mbi bashkësinë tonë, falënderojmë prindërit dhe gjithë ata që na ndihmojnë, gjithashtu falënderojmë edhe rektorin tonë don Antonin për kontributin e tij të madh dhe shumë të çmueshëm që vazhdon të japë për ritjen, formimin dhe shenjtërimin e jetës sonë. Dhe, në fund, ftojme të gjithë besimtarët që të vazhdojnë të lutën për ne dhe për thirrje të mira dhe të shenja në Kishën dhe në popullin tonë.

Seminaristët, Prizren

Në Zym të Hasit u mbajtën "Takimet e Gjeçovit 2009"

U përkujtua 80-vjetori i martirizimit të Atë Shtjefën Gjeçovit

■ SHKRUAN:
Albert MARJAKAJ

Në Zym të Hasit, komuna e Prizrenit, më 10 tetor të këtij viti (2009), u mbajt edicioni 38 i manifestimit tradicional letrar, kulturor e shkencor "Takimet e Gjeçovit". Ky manifestim sivjet u mbajt nën patronazhin e Presidentit të Republikës së Kosovës. Nga pjesëmarrësit e shumë të këtij manifestimi doli vlerësimi se edicioni i sivjetmë i këtij manifestimi ishte më i suksesshmi deri me tash.

Para fillimit të manifestimit, Presidenti Sejdiu ka vizituar familjen e Pjetër Ndreke Prekpalaj në fshatin Zym, ku u prit me bukë, kripë e zemër. Në një ambient të ngrohtë familjar, Presidenti Sejdiu është njoftuar me preokupimet e kësaj familjeje dhe banorëve të tjerë të Zymit dhe të fshatrave përreth, shkollimin e fëmijëve, sigurimin e ujit të pijshëm dhe kushteve të tjera për jetesë e të tjera. Më atë rast shpënesha e familjes, zonja Marije Prekpalaj, Presidentit të Republikës së Kosovës i dhuroi pjesë të kostumografisë karakteristike të Zymit të Hasit.

Më pas ai ka zbuluar monumentin e ngritur për kontributin e pronarëve të shtëpiave - shkolla të dhënë për mbarëvajtjen e arimit shqip në vitet e rënda 1991-1999 nga banorët e fshatrave Zym, Shëngjergj dhe Bregori, të cilin monument e ngriti Këshilli organizativ i manifestimit "Takimet e Gjeçovit".

Manifestimi vazhdoi në Kompleksin përkujtimor "Atë Shtjefën Gjeçovi", ku gjithmonë mbahet ky manifestim. Aty, së pari Nikollë Kërhanaj, shpalli të hapur manifestimin e sivjetmë, i cili për dallim nga vitet tjera, sivjet u mbajt nën patronazhin e Presidentit të Republikës së Kosovës, zotëri Fatmir Sejdiu. Ndërkaj, Frrok Kristaj përshën-

deti të pranishmit, e në veçanti presidentin Fatmir Sejdiu, pastaj Ipeshkvën e Kosovës, Shkëlqesinë e tij Imzot Dodë Gjergjin, ministrin e Kulturës Valton Beqirin, kryetarin e Komunës së Prizrenit Ramadan Mujën, etj.

Në vazhdim presidenti i Republikës së Kosovës, zotëri Fatmir Sejdiu, pasi vendosi një buqetë lulesh para shtatores së Atë Shtjefën Gjeçovit, me një fjalë rasti iu drejtua edhe pjesëmarrësve të këtij manifestimi, me ç'rast ndër të tjera tha se populli shqiptar mburret me Atë Shtjefën Gjeçovin. Ishte njeri edhe i punës edhe i penës.

Duka lartësuar figurën e Shtjefën Gjeçovit, Presidenti Sejdiu ka theksuar një citat nga pasuria e madhe që la mbrapa Gjeçovi: Shtëpia e shqiptarit është e Zotit dhe e Mikut. "Merni dhe zbërtheni. Aty e keni edhe nderin, edhe besën, edhe mikpritjen, edhe mbrojtjen dhe shumë të tjera që rrallëkund mund t'i gjeni. At Shtjefën Gjeçovi i ka mbledhur nga goja e popullit nga tradita e popullit dhe i ka bërë bashkë", theksoi Presidenti Sejdiu, duke shtruar se materia e mbledhur nga Shtjefën Gjeçovi jo vetëm që është një pasuri shumë e madhe për kulturën dhe historinë e popullit shqiptar, por ajo ka kapërcyer kufijtë dhe është bërë objekt studimi i shumë ekspertëve nga vende nga më të ndryshme të botës.

Në këtë kontekst, ai përmendi librin e një autori japonez, me titull "Struktura etike e Kanunit të Lekë Dukagjinit", në të cilin ai nxjerr shumë përfundime dhe thekson se kryevepra e Gjeçovit është një dhe unikate.

"Përkushtimi i institucioneve të vendit për të mbajtur një traditë kujtimi, për të dhënë shansin e fjalës edhe për vepër letrare, edhe për studime, edhe për aspekte kulturore, edhe për rezistencën, kanë gjetur një rrugë të mirë që këto takime, në këtë

vend të bekuar, të jenë tradicionale", theksoi më tej Presidenti Sejdiu, duke lavdëruar angazhimin që ky manifestim të mos ketë asnjëherë shkëputje dhe që të shkojë vetëm duke u rritur e duke zgjeruar gamën e pjesëmarrjes.

"E dimë të gjithë se e keni pasur vështirë në kohë të vështira. E dimë se keni shkuar për kafshatën e gojës skajeve të dynjasë, por e di se keni marrë me vete Kosovën dhe keni ardhur në Kosovë, andaj mos u shkëputni asnjëherë nga porositë e njerëzve të mëdhenj të këtij vendi", porositi Presidenti Sejdiu banorët e Zymit dhe gjithë hasjanët.

Nga të gjithë të pranishmit më manifestim, sidomos nga banorët dhe veprimtarët e kësaj ane është prituri me gëzim shumë të madh deklarimi i Presidentit Sejdiu për të ofruar ndihmën e institucioneve të vendit që në këtë vend të ngrihet edhe shtatorja e Pjetër Bogdanit, një studiuesi dhe burri të madh shqiptar, i vrarë edhe ai, sikur Shtjefën Gjeçovi, pikërisht për shkak të angazhimeve të tyre kombëtare në kohë të rëndë për të gjithë shqiptarët.

"Gjeçovin e Bogdanin i vranë, i hoqën nga jeta ata që nuk deshën të na shohin gjallë. Por, ne jemi gjallë, vazhdojmë jetën", theksoi Presidenti Sejdiu. Presidenti Sejdiu ka përcjellë gjithë aktivitetet e organizuara në kuadër të këtij manifestimi prestigjioz dhe tradicional, që ka mbledhur shumë figura publike të politikës e kulturës, si dhe shumë banorë të kësaj ane, që tashmë jetojnë në viset të tjera të Kosovës apo edhe jashtë shtetit.

Më pas pjesëmarrësve me një fjalë rasati iu drejtua edhe Ipeshkvi i Kosovës, Shkëlqesia e tij, Imzot Dodë Gjergji, kryetari i komunës së Prizrenit, Ramadan Muja dhe kryetari i Shoqatës kulturore "Vakrani" nga Vlora, Dr. Asqeri Llanaj.

Në këtë manifestim është



Presidenti Fatmir Sejdiu gjatë fjalimit në Manifestim

shënuar edhe 80-vjetori i martirizimit të Atë Shtjefën Gjeçovit, emrin e të cilit e mbanë edhe ky manifestim. Ky përvjetor u shënuar me një monolog nga drama e Pjetër Përgjokës "Murana", e në regji të Frrok Kristajt, ku interpretuan aktorët e mirënjohur të Teatrit Kombëtar të Prishtinës, Bislim dhe Hysniye Muçaj së bashku me disa të rinj zymjanë.

E veçanta e manifestimit të sivjetmë padyshim se ishte kur përfaqësuesi i familjes Dulaj, përndryshe djali i vëllait të Katarina Josipit, në emër të të gjithë pjesëtarëve të familjes së Mark Xhin Dulajt (vëllai i Katarinës), para pjesëmarrësve të këtij manifestimi deklaroi se i fal Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, shtëpinë e lindjes së Katarinës për t'u bërë muze kombëtar, me ç'rast këtë e pranoi por edhe e falenderoi ministri i Kulturës, zotëri valton Beqiri, i cili edhe premtoi se në një të ardhme të afërt Shtëpinë e lindjes së Katarina Josipit - Katit, do ta shndërroj në muze.

Si zakonisht në këtë manifestim u mbajt edhe "Ora e Anton Pashkut", ku poetët e përzgjedhur (nga juria Besim Muhadri, kryetar, Zana Pira, poetë, dhe Prend Buzhala, shkrimtar) në bazë të një konkursi letrar, që e kishte publikuar organizatori, i kishte përzgjedhur disa poetë.

Organizatorët edhe kësaj radhë kanë çmimin "Unaza e Katit", që laureate sivjet ishte Leze Spaçi - Qena e të cilën ia dorëzoi Dr. Zef Lekaj.

Pastaj Dr. Eqrem Zenelaj, profesor universitar, Muzeut të Zymit i dhuroi vepërën e Shtjefën Gjeçovit "Agimi i gjydetnis", të cilën e kishte sjellë nga Vjena, por e dhuroi edhe vepërën e vet kushtuar Papës Klementi XI - Albanit.

Njëherësh Muzeut të Zymit i dhuroi një fotografi të rrallë Dr. Asqeri Llanaj, nga Vlora, si dhe Frrok Prekpalaj, që punon në Zagreb, i dhuroi Frrok Kristajt afro 3000 faqe materiale kushtuar Zymit të nxjerra nga Arkivi Shtetëror i Austrisë në Vjenë.

Në fund Shoqëria kulturo-artistike "Katarina Josipi" e Zymit, e udhëhequr nga Bibë Berisha, kryetar dhe Lajde Kolëgjera, koreografe, shfaqen një program artistik, që u pëlqye shumë nga pjesëmarrësit e "Takimeve të Gjeçovit 2009".

Vlen të theksohet se gjatë vizitës në Zym, Presidenti Fatmir Sejdiu ka vizituar edhe Kishën e Zojes së Hasit në këtë fshat, ku Ipeshkvi i Kosovës, imzot Dodë Gjergji dhe kancelari dhe famullitari i deritashëm Dr. Don Shan Zefi, kanë shtruar drekë për Presidentin e Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.



Në Stubëll të Epërme u mbajtën Takimet e Don Mikel Tarabulluzit

Më 26 shtator në Stubëll të Epërme është mbajtur Manifestimi tashmë tradicional, "Takimet e Don Mikelit", i cili i kushtohet legalizimit të Shkollës parë shqipe me 1905 në Stubëll të Epërme dhe mësuesit të saj e priftit të devotshëm, don Mikel Tarabulluzit. Ky manifestim, në të cilin morën pjesë shumë figura të jetës politike, shkencore e kulturore, filloj me mesheën, të cilën e drejtoi Imzot Dodë Gjergji, ipeshkvë i Kosovës.

Ndërkaj pjesa shkencore kishte për temë boshte, "Letërsia dhe Identiteti", në të cilën u diskutua për relacionet mes letërsisë shqipe dhe krijimit të identitetit shqiptar, nga studiuesi Ramadan Musliu e Luljeta Isaku.

Ndërkaj pas kësaj, pasoja ora letrare, në të cilën u lexuan shumë poezi nga krijues shqiptarë. Pas kësaj u ndanë çmimet tradicionale "Agim Ramadanit", ndërsa me çmime in e parë u nderua Flamur Maloku, të dytin Hida

Halimi dhe të tretin Mehmetali Rrexhepi.

Gjithashtu në këtë manifestim u nda çmimi tradicional Fondacioni për kontribute në letërsi e kulturë i Akil Kocit që kësaj radhe iu dhua krijuesve Ibrahim Kadriu dhe Prend Buzhala.

Pas orës letrare ishte një program i pasur zbavitës dhe kokteji i rastit për mysafirët e shumtë, të ardhur ane e kënd Kosovës.

Ndue Ukaj

10 Vjetori i bashkëpunimit të Rrjetit Ndërkombëtar të Karitasit në Kosovë

10 vite balancë të emergjencës, rindërtimit dhe punës zhvillimore

■ PËRGATITËN:
Vildane MINCI dhe
Geri MEILI

Në qershor të vitit 1999, menjëherë pas luftës, rrjeti ndërkombëtar i Caritas-it filloi me një emergjencë të madhe dhe me rindërtim. E vendosi zyrën e vet koordinuese në kompleksin e ndërtesës katolike në Prizren. Për nder të dhjetëvjetorit të tij, më 15 tetor 2009, Caritas-i i Kosovës dhe Caritas-i zviceran, si agjenci udhëheqëse e Rrjetit Ndërkombëtar të Caritas-it ka organizuar një konferencë për shtyp në Prizren. Ishte bërë një balancë në emergjencë dhe në punën e rindërtimit: mbi 5.000 shtëpi janë rindërtuar, janë rinovuar ndërtesa shtesë shkollore dhe sisteme elektrike. Që nga 2004 Rrjeti i Caritas-it ka vazhduar me punë zhvillimore. Tri organizata të Caritas-it, ai i Kosovës, Luksemburgut dhe Zvicëran ndajnë një prioritet të posaçëm, të promovojnë edukimin dhe integrimin e minoriteteve. Fokus i veçantë është në rajonin e Prizrenit, Dragashit dhe Shtërpçës me komunitet të ndryshme RAE, boshnjakë, serbë, goranë. Donatorët kryesorë për këtë projekt janë Qeveria e Lihtenshtajnit, Caritas-i dhe Qeveria e Luksemburgut, Qeveria Zvicerane (SDC/OFM), Zinxhiri Zviceran i Solidaritetit, Dioqeza e Bazelit dhe Fondacioni Medicor në Lihtenshtajn.

Don Viktor Sopi, Drejtor i Caritas-it të Kosovës e hapi konferencën duke u dëshiruar mirëseardhje të gjithë mysafirëve prezente dhe përfaqësuesve të mediae.

Ispeshkvi Dodë Gjergji e hapi konferencën me fjalën përshëndetëse për pjesëmarrësit në këtë përvjetor të rëndësishëm të Caritas-it të Kosovës, Caritas-it Zviceran dhe Rrjetit të Caritas-it në përgjithësi. Ispeshkvi dërgoi mesazh për bashkëjetesë paqësore dhe bashkëpunim të njerëzve pa dallim etnik, fetar, racor dhe për-

aktim politik.

Don Viktor Sopi në fjalimin e tij tha se Caritas-i i Kosovës zyrtarisht është themeluar në vitin 1992, edhe pse në disa famulli aktivitetet e bamirësisë kanë filluar edhe më herët. Që nga 1999, me mbështetjen e Rrjetit Ndërkombëtar të Caritas-it, Caritas-i i Kosovës filloi të zhvillojë dhe të shpërndajë aktivitetet e veta nëpër tërë Kosovën. Në fakt, Caritas-i i Kosovës ka shpërndarë aktivitetet e veta në Ferizaj, Prizren, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë dhe Gjakovë me mbështetje të fortë të Caritas-it gjerman, zviceran, francez, italian, të Luksemburgut, Spanjës, Austrisë, Republikës Çeke, etj. Vitin e kaluar, shumë organizata tjera të Caritas-it, me programet dhe stafin e tyre janë integruar në strukturat e Caritas-it të Kosovës.

Periudha 2007-2009 për Caritas-in e Kosovës është periudhë e rindërtimit. Në vitin 2008, Caritas Kosova filloi të punojë në zhvillimin e Strategjisë operative 2008 - 2012 si një dokument bazik për anëtarësim në Caritas Europe. Bazuar në këtë dokument, Caritas Kosova ka fokusuar aktivitetet e veta në 3 departamente kryesore: zhvillim dhe infrastrukturë sociale, shëndetësor dhe ekonomik dhe implementimin e tyre përmes projekteve dhe programeve të ndryshme në tërë Kosovën.

Caritas Kosova vazhdon me bashkëpunim të afërt me gjitha strukturat udhëheqëse të Caritas Evropë, me institucionet vendore dhe ndërkombëtare si institucione të njohura, të pranuar dhe respektuara nga shoqëria Kosovare, përfundoi Don Viktor Sopi.

Erich Ruppen, Kryesues i Departamentit për Europë / CIS nga Caritas-i Zviceran raportoi mbi punën në Emergjencë dhe Rindërtim gjatë periudhës 1999 - 2003. Rrjeti i Caritas-it filloi me ndihmën e tij për popullin e Kosovës që nga shkurti 1999 në Shqipëri dhe Maqedoni. Në fazën e emergjencës rreth 140.000 njerëz nevojtarë në 267 fshatra të rajonit të Prizrenit janë ndihmuar me



tenda, pajisje themelore të amvisnisë, veshmbathje dhe dru për dimër. Në fazën e rindërtimit janë rindërtuar 5257 shtëpi, infrastruktura e fshatit dhe ajo bujqësore në komunën e Klinës, të Prizrenit, Pejës, Malishevës, Drenasit, Gjakovës, Suharekës dhe Dragashit. Programi ka vazhduar me rindërtimin e 198 shtëpive në komunat e Prizrenit, Dragashit dhe Shtërpçës kryesisht për minoritetet. Paralelisht janë rindërtuar 9 shkolla në Malishevë, Prizren, Pejë, Drenas dhe Gjakovë. Partnerët kryesorë të Caritas-it në fazën e rindërtimit ishin Caritas Kosova, Caritas Gjermania, Caritas Italia, Caritas Franca, CRS, Caritas Luksemburg dhe Caritas Zviceran me mandat të Caritas-it Ndërkombëtar për të koordinuar Rrjetin e Caritas-it.

Pas 10 viteve Caritas-i është duke ofruar mbështetjen e tij në fushën sociale, arsim, ndërtim të paqes dhe bënë përpjekje tjera zhvillimore.

Fjalimi i Ramadan Mujës, Kryetar i Asamblesë Komunale ishte fokusuar në bashkëpunimin e institucioneve komunale dhe Caritas-it në integrimin e minoriteteve në komunën e Prizrenit. Kryetari përmendi bashkëpunimin korrekt dhe të rregullt me Caritas-in që nga 2003 në përbashkjen e synimeve të përbashkëta për përmirësimin e kualitetit jetësor dhe të shërbimeve për qytetarët e Prizrenit në fushën e arsimit, infrastrukturë dhe integrim të minoriteteve. Komunitetet minoritare në Luginën e Zhupës dhe komunitetet RAE në Prizren ishin grupe të fokusuara të këtij bashkëpunimi, por ia vlen të përmendet përfshirjen e të gjitha komuniteteve në këtë bashkëpunim frytdhënës.

Në fund, Kryetari shprehi falënderimin e tij për kontributin e Caritas-it dhe implementimin e suksesshëm të projekteve që kanë një rëndësi të madhe në

përmirësimin e kushteve jetësore, kualitet dhe integrim të minoriteteve, në të njëjtën kohë duke shprehur gatishmërinë e komunës së Prizrenit për bashkëpunim të mëtejshëm me Caritas-in.

Konferenca vazhdoi me fjalimin e Raif Elezit, Zëvendës Ministër në Ministrinë për Qeverisje Lokale. Ai theksoi bashkëpunimin e institucioneve qeveritare me Caritas-in për integrimin e minoriteteve në shoqërinë Kosovare. Z. Elezi ceki implementimin fazës së parë dhe të dytë të sistemit të ujësjellësit në Reqaqë si një shembull të mirë të bashkëpunimit të institucioneve qeveritare dhe komunale, të komunitetit dhe Caritas-it. Vlerësim i lartë i është dhënë Caritas-it për ofrimin e mundësive të barabarta grupeve të ndryshme etnike dhe sociale që jetojnë në rajonin e Prizrenit dhe më gjerë në Kosovë. Fjalimi i z. Elezit përfundoi me urimet për rezultatet e aritura deri tani dhe uroi projekte të suksesshme në të ardhmen në përmirësimin e mirëqenies në Kosovë.

Fjalimi i fundit u mbajt nga Z. Geri Meili, Përgjegjës për Caritas-in zviceran - programi për Kosovë në Luzern. Ai paraqiti strategjinë aktuale për zhvillim në Kosovë. Ai theksoi fushat më të prioritëta: integrimin social dhe arsimimin e minoriteteve. Që të dyja janë implementuar në partneritet me Caritas-in e Kosovës dhe të Luksemburgut. Duke synuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe zotërim vendor, është themeluar bashkëpunimi me tri grupe të ndryshme partnerësh në Kosovë: autoritetet komunale dhe qeveritare, komunitetet dhe OJQ-të lokale. Z. Meili paraqiti përvojën e suksesshme të dy projekteve. Projekti "Integrimi i Minoriteteve / MAAR" ka për qëllim forcimin e komuniteteve minoritare, të promovojë zhvillimin e fshatit dhe të pjesëmarr-

rjes komunale si dhe dialogun ndëretnik dhe ndërtimin e paqes. Ky projekt është duke u implementuar në komunat e Prizrenit, Dragashit dhe të Shtërpçës me komunitete të boshnjakëve, RAE, goranë, serbë, dhe shqiptarë. Shembuj të mirë të bashkëpunimit janë përmirësimi i ujësjellësit në Reqaqë, si dhe renovimi, pajimi dhe funksionimi i Qendrës për Komunitete në lagjen Jeta e Re në Prizren.

"Projekti i Arsimit Parashkollor" është duke u implementuar në Drenas, Prizren dhe në Gjakovë. Synimet e projektit janë të kontribuojë në zhvillimin e arsimit parafillor në Kosovë që do të bëhet i obligueshëm në vitin 2009, përfshirja e një numri më të madh të fëmijëve dhe arsimimi dhe kualifikimi i mësuesve për të përshtatur kurikulën moderne parashkollore. Mementalisht në komunën e Prizrenit janë rinovuar, pajisur dhe funksionojnë 2 qendra parafillorë. "Mollëkuqet" me 169 fëmijë, nga ta 22 janë RAE, 10 turq, 6 boshnjakë dhe 131 shqiptarë. Për Caritas-in dhe komunën kjo është një përvojë unike në Kosovë që demonstron bashkëpunimin ndëretnik fushën e arsimit.

Në fund, Z. Meili përfundoi me fjalën se Caritas-i është i vetëdijshëm për nevojat e mëdha dhe vështirësitë zhvillimore në Kosovë dhe se partnerët Kosovarë mund të sigurohen për kontribut të mëtejshëm të Rrjetit Ndërkombëtar të Caritas-it drejt një përpjekjeje për zhvillim afatgjatë dhe integrim Evropian të Kosovës.

Me këtë rast, Caritas-i ka organizuar një foto ekspozitë me fotografi që paraqesin të gjitha fazat e punës së Caritas-it në Kosovë. Rreth njëqind punëtorë aktualë dhe të përparmë ndërkombëtarë dhe vendorë janë ftuar në darkën jubilarë dhe disa pionierë që kanë filluar në vitin 1999 janë nderuar.



Erich Ruppen, Geri Meili, Don Viktor Sopi, Dodë Gjergji, Ramadan Muja, Raif Elezi

U kremtua festa e Zojës Rruzare në famullinë e Bishtazhinit

Për tu përgatitur sa më mirë shpirtërisht për festën e Zojës Rruzare besimtarëve të famullisë sonë, dhe jo vetëm, ju dha mundësia që përmes tri ditsh të shenjtë të ja arrijnë më mirë këtij qëllimi.

Ditën e parë të tri ditsh të shenjtë, Meshën shenjte e udhëhoqi don Pal Tunaj, të dytën famullitari i kësaj famulli don Rrok Gjollleshaj dhe natën e festës e pati meshën don Lush Sopi famullitar në Novo Sellë.

Gjithashtu ne tri ditshin e shenjtë të Zojës Rruzare kontribut të madh dhanë edhe shumë meshtar të tjerë, që ishin të gatshëm të rrëfenin gjatë gjithë kohë; edhe motrat e nderit të bashku me të rinjtë dhe të rejtat e famullisë nuk kursyen asgjë për të qen në shërbim të besimtarëve në mënyrë që çdo gjë të shkoj mbarë dhe mirë. Në këtë tri ditësh morën pjesë shumë besimtar, jo vetëm nga famullia e Bishtazhinit por edhe nga famullit tjera të rrethit. Lirisht mund të themi se ky tri ditësh ishte për të gjithë besimtarët pjesëmarrës si një rrugë e hapur



Mons. Lucian Augustini,
ipeshkëvi i Shqipërisë

që shpinte drejtë parajsës, drejtë takimit me Nënë tonë shumë të dashur Zojën e Bekuar.

Ditën e festës së Zojës meshën shenjte e udhëhoqi Imzot Lucian Avgustini ipeshkëvi i Sapës, në bashkmeshim me të

ishin edhe shumë meshtar dhe rregulltar.

Mons. Lucjani në prektun e rastit theksoi rolin e Zojës së Bekuar në jetën e një të krishteri dhe në mënyrë krejt të veçantë shpjegoi rëndësinë dhe rolin e madh që ka urata dhe rruzarja shenjte në jetën dhe në familjen e të krishterit.

Në fund të meshës, famullitari don Rroku, falënderoi Zotin, udhëheqësin e Meshës Shenjte mons. Lucjan Avgustinin, meshtarët, rregulltarët, rregulltarët dhe gjithë të pranishmit në Meshë duke uruar që ndërmjetësia dhe shembulli i Zojës Rruzare të na mbrojnë dhe të na mbajë gjithmonë nën hijen e krahëve të sajë.

Menjëherë pas meshe për të gjithë të pranishmit ishin të hapura dyert dhe zemrat e gjithë besimtarëve të Bishtazhinit për të pritur dhe festuar së bashku me gjithë ata miq dhe dashamirë që kishin ardhur për të bashkëndarë me ne festën, gëzimin dhe dashurinë e të qenurit vëllezër në Krishtin.

Monika Nokaj

Liria fetare më e rëndësishme sesa liria e fjalës

"Liria fetare është një e drejtë themelore dhe më e rëndësishme sesa liria e fjalës". Kështu nënvizoi Imzot Antoni R. Fronteiro, përfaqësues i Këshillit Papnor për "Drejtësi dhe Paqe", në fjalimin mbajtur në Varshavë gjatë mbledhjes të Zyrës për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) të OSBE-së, që është Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin Evropian.

Duke kujtuar se sfidat që lidhen me lirinë e mendimit, ndërgjegjen, fenë dhe besimin duhen trajtuar, prelati pohoi se "disa nga këto sfida shpesh manifestohen në akte të mos-tolerancës, dhunës dhe diskriminimeve por edhe në ndërhyrjen

e shteteve tek kultet fetare".

"Gjithashtu – vuri në dukje Imzot Fronteiro – kohët e fundit kanë lindur edhe probleme të tjera që lidhen me një shoqëri gjithnjë e më relativiste, në të cilën ka orvatje për ta mposhtur lirinë fenë" ose për ta asgjësuar krejtësisht në emër të mbrojtjes të të drejtave të tjera.

Me rëndësi të madhe, pra, për delegacionin e Selisë së Shenjtë të vinte në pah atë çka vetë OSBE-ja ka deklaruar për lirinë fetare: "Njeriu ka të drejtë të gëzojë liri fetare, një e drejtë që buron nga vetë dinjiteti dhe natyra e njeriut, një e drejtë që na kujton se të gjithë njerëzit, burra e gra, janë të pajisur me arsye dhe me vullnet të lirë dhe prandaj kanë

përgjegjësi personale." "Shtetet – vijoi prelati – janë të detyruara të respektojnë dhe t'u garantojnë të gjithëve të drejtën e fesë dhe të besimit, janë të detyruara të pranojnë se liria fetare është provë që tregon se respektohen të gjitha të liritë e tjera."

Imzot Fronteiro shtoi pastaj se duhet të ketë një dallim të vërtetë ndërmjet shtetit dhe fesë, por se kjo e fundit nuk duhet të ndahet nga jeta shoqërore dhe kulturore sepse përfaqëson "një kontribut të rëndësishëm dhe pozitiv për të gjitha ato shoqëri ku liria e fesë respektohet. Në përfundim delegati i Vatikanit i ftoi shtetet të promovojnë ndihmesën që liria e fesë mund t'i ofrojë edhe shoqërisë në përgjithësi.

Në Kretë u mbajt mbledhja plenare e Komisionit "Fe e Kushtetutë" e Këshillit Ekumenik të Kishave

"Një dëshirë e thellë për unitet i shtyu Kishat të takohen në Kretë, për të zbuluar rrugët e mundshme që çojnë drejt bashkimit". Me këto fjalë imzot Gregori Xhejms Feirbanks paraqiti gjendjen shpirtërore, me të cilën 120 anëtarët e kishave përkatëse marrin pjesë në sesionin plenar të Komisionit "Fe e Kushtetutë" të Këshillit Ekumenik të Kishave (Wcc),

mbledhur pranë Akademisë ortodokse të Kolimparit, në Kretë. Tri janë temat kryesore rreth të cilave u diskutua: ç'do të thotë Kisha; burimet e autoritetit e të gjykimit moral. Komisioni po analizon qëndrimin që duhet të mbajnë Kishat mbi çështjet e ndërlukuara si prozelitizmi, homoseksualiteti dhe kërkimet në fushën e qelizave staminale. Pyetjes mbi shpresat e lëvizjes

ekumenike, don Xhejms Puljisi, drejtor i 'Qendrës për bashkim' dhe anëtar i delegacionit katolik, iu përgjigj: "Kishat anëtare të Komisionit Fe e Kushtetutë po punojnë për këtë qëllim që nga viti 1927, duke bërë hapa të dukshme përpara, gjë që e vërteton dokumenti i marrëveshjes mbi Pagëzimin, Eukaristinë dhe shërbimin meshtarak".

Statistika e Kishës katolike në kremtimin e ditës së Misioneve



Popullata botërore – katolikët

Kontinenti	Popullata	Katolike	Përqindja
Afrika	943.743.000 (+ 16.865.000)	164.925.000 (+ 6.612.000)	17,48 % (+ 0,40)
Amerika	907.393.000 (+ 11.327.000)	568.570.000 (+ 5.535.000)	62,66 % (+ 0,17)
Azia	4.024.970.000 (+ 43.304.000)	120.894.000 (+ 2.428.000)	3,00 % (+ 0,02)
Evropa	706.798.000 (+ 2.246.000)	283.240.000 (+ 1.132.000)	40,07 % (+ 0,03)
Oqeania	34.193.000 (+ 531.000)	9.027.000 (+ 199.000)	26,43 % (+ 0,17)
Gjithsej	6.617.097.000 (+ 74.273.000)	1.146.656.000 (+ 15.906.000)	17,33% (+ 0,05)

Gjithsej ipeshkvijn në botë:

Kontinenti	Gjithsej ipeshkvijn	Ipeshkvijn dioqezanë	Ipeshkvijn rregulltarë
Afrika	657 (+ 19)	474 (+ 12)	183 (+ 7)
Amerika	1.847 (- 2)	1.278 (=)	569 (- 2)
Azia	732 (+ 12)	539 (+ 10)	193 (+ 2)
Evropa	1.576 (+ 13)	1.349 (+ 15)	227 (- 2)
Oqeania	134 (+ 6)	89 (+ 3)	45 (+ 3)
Gjithsej	4.946 (+ 48)	3.729 (+ 40)	1.217 (+ 8)

Meshtarë në tërë botën janë:

Kontinenti	Gjithsej meshtarë janë:	Meshtarë Dioqezanë	Meshtarë rregulltarë
Afrika	34.658 (+ 1.180)	23.154 (+ 1.024)	11.504 (+ 156)
Amerika	121.495 (+ 376)	79.654 (+ 853)	41.841 (- 477)
Azia	52.802 (+ 1.521)	30.991 (+ 864)	21.811 (+ 657)
Evropa	194.393 (- 2.260)	135.971 (- 1.392)	58.422 (- 868)
Oqeania	4.676 (- 55)	2.661 (- 9)	2.015 (- 46)
Gjithsej	408.024 (+ 762)	272.431 (+ 1.340)	135.593 (- 578)

Motra te nderit në tërë botën janë:

Kontinenti	Motra te nderit
Afrika	61.886 (+ 1.178)
Amerika	206.509 (- 4.650)
Azia	158.692 (+ 2.838)
Evropa	310.138 (- 5.843)
Oqeania	9.589 (- 109)
Gjithsej	746.814 (- 6.586)

(+) d.m.th. më shumë se vitin e kaluar

(-) d.m.th. më pak se vitin e kaluar

Sinodi për Afrikën: kontinenti të bëhet protagonist i fatit të vet

Afrikën duhet të bëhen protagonistë të fatit të tyre: ky është urimi i ipeshkvijve gjatë Sinodit II për Afrikën, që vazhdon në Vatikan mbi temat e pajtimit, drejtësisë e paqes. Sesioni i pesëmbëdhjetë u karakterizua nga paraqitja e relacioneve të grupeve të vogla. Në praninë e Papës Benedikti XVI, etërit sinodalë filluan të përvojvijnë tematikat e mundshme për t'u paraqitur në dokumentet përfundimtare të Asamblesë.

Sipas raportit të grupeve të vogla, puna e bërë deri tani është pozitive, por disa aspekte duhen nënvizuar më tepër. Të tilla janë nevojat për mbrojtjen e ambientit, dallimi më i mirë i thirrjeve të vërteta, vendosja e traditave afrikane në bazë të procesit të pajtimit. Pikërisht në këto tradita janë të pranishme shumë

elemente pozitive, që mund të pajtohen me krishterimin, si riti i pranimit të fajt, ose premtimi për të mos rënë sërish në gabim.

Etërit Sinodalë sugjerojnë të përhapen më shumë tekstet, që informojnë mbi Doktrinën e Kishës në fushën e seksualitetit, kërkojnë kujdes më të madh baritor për punëtorët, për familjen dhe për gratë, duke përfshirë edhe rregulltarët. Gjithashtu, duhet vëmendje për fenomenin e magjisë, e cila dëmton rëndë shoqërinë afrikane, dhe për marrëdhëniet me Islamin, që duhen parë sipas rasteve, pasi myslimanët në Afrikë ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin.

Më shumë hapësirë i duhet dhënë edhe problemit të emigracionit, por në kuadrin e politikave ndërkombëtare dhe

të rolit qendror të Kishës në mbrojtje të të drejtave të njeriut e të dinjitetit të tij. Përsëritet nevoja për të forcuar lidhjet ndërmjet kishave lokale dhe asaj universale e për të arritur unitetin e plotë në ato organizma, që përmbledhin Konferenca të ndryshme Ipeshkvnore.

Më tej, etërit sinodalë kujtojnë rëndësinë e mas-medieve për komunikimin kishtar e edhe për formimin e popullsisë: radioja e televizioni për shembull, mund të kontribuojnë për të përcuar vlerat e jetës familjare. Për sa u përket vendeve në krizë politike, në Sinod u tha që procesi i pajtimit duhet çpolitizuar e Kisha nuk duhet të jetë kurrë peng e konflikteve institucionale. Ajo duhet t'i shoqërojë krerët e vendit në ushtrimin e pushtetit, larg prej korrupsionit.

Përveç kësaj, grupet e vogla të Sinodit kërkojnë edhe masa të vendosura kundër trafikut të armëve e të drogës e kundër pandemisë së sidës, sidomos përmes ndryshimit të mënyrës së jetesës.

Theksohet më pas rëndësia e përkrahjes së shkollave dhe universiteteve katolike, e rregullave të forta për personat e shuguruar, për të cilët duhet menduar një formim i vazhdueshëm, e përfshirjes së laikëve në punën e ungjillëzimit.

Së fundi, etërit sinodalë sugjerojnë thirrjen e një Kongresi eukaristik kontinental, një takim panafrikan mbi gratë dhe ngritjen e një forumi për lutjen ndërfaqetare, pasi në një vend ku ka konflikte e dhunë, lutja e përbashkët është hapi i parë drejt paqes.

Dëshmi dramatike e një ipeshkvi të Sudanit: të krishterët kryqëzohen

Në veçanti tërhoqi vëmendjen e Sinodit për Afrikën, gjendja në Sudan, vend i ndarë me veriun kryesisht arab, që ka imponuar ligjin e Kuranit, e me jugun të krishterë animistë. Zgjedhjet politike, të parashikuara me marrëveshjen e paqes 2005, duhet të zhvillohen brenda

nevojshme për të përgatitur referendumin e vitit 2011.

Në pyetjen e bërë: A sulmohet edhe bashkësia e krishterë?

Ipeshkvi u përgjigj: "Po. Më 13 gushtin e kaluar, rebelët hynë në kishën e famullisë sime dhe morën shumë persona peng. Ndërsa ikin në pyll, vranë



vitit 2010, ndërsa për vitin 2011 është fiksuar një referendum për vetëvendosjen e Jugut. Të gjitha këto mund të jenë në rrezik për shkak të dhunës së grupeve rebelë, të lidhura me qeverinë e Khartumit. Kështu pohen imzot Hiiboro Kusala, ipeshkvë i dioqezës jugore të Tombura Yambio, teatër sulmesh të vazhdueshme kundër të krishterëve:

Këta rebelë, siç e shohim ne punën, po marrin ndihma nga qeveria e veriut, Të gjithë kanë pushkë, armë... Mendoj se duan ta lënë jugun e Sudanit në vështirësi, që të mos ketë paqen e

shatatë prej tyre: i kryqëzuan nëpër pemë. Ka shumë drama si kjo. Disa prej rebelëve kanë mësuar nga Al Kaida në Afganistan: janë kundër Kishës. Plani i tyre është të frikësojnë të krishterët".

Të jetosh Ungjillin është e vështirë, mund edhe të martirizohesh...

Po. Ne po përjetojmë pikërisht këtë, pasi po vrasin njerëz, u djegin shtëpitë, kishat: ky është martirizim. Të krishterët kanë frikë. Por ne nuk duam të vdesim. Gjithçka ndodh përforcon fenë, njerëzit vazhdojnë të vijnë në kishë.

Imzot Zimovski: shëndetësia dominohet jo nga etika, por nga logjika industriale

Ekziston rreziku i një katastrofe humanitare e shëndetësore botërore: ky është shqetësimi i Papës Benedikti XVI, që kryetari i Këshillit Papnor për Baritorinë e Shëndetit, imzot Zigmunt Zimovski e shpreh në Kongresin Botëror të Federatës Ndërkombëtare të Farmacistëve Katolikë. Takimi u zhvillua në Poznan të Polonisë mbi temën: "Siguria e ilaçeve: etika dhe ndërgjegjia e farmacistit".

"Në shumë zona – denoncoi prelati – mungojnë ilaçet më të domosdoshme, asistenca bazë që garanton jetën. Shpesh, për motive ekonomike, nuk kurohen sëmundje tipike të vendeve në zhvillim, sepse, megjithëse u shkaktojnë vdekjen miliona njerëzve, nuk përbëjnë një treg të pasur. Disa nga këto ilaçe mund të realizohen lehtë mbi bazën e njohurive aktuale shkencore, por nuk e shohin dritën e dëlclit për motive tjesh ekonomike, pasi të sëmurët nuk kanë mundësi të mjaftueshme për t'i blerë. Duket qartë – theksoi imzot Zimovski – se zhvillimi i ilaçeve nuk qeveriset më nga etika tradicionale e mjekësisë, por nga logjika e industrisë".

Një problem tjetër dramatik – vazhdoi imzot Zimovski – është falsifikimi i ilaçeve, gjë që dëmton kryesisht fëmijët. Antibiotikë e vakcina të rreme, me dozazh më të ulët, ose krejtësisht pa principin aktiv, shkaktojnë dëme të rënda për shëndetin e tyre. Të shumta janë vdekjet ndër fëmijët afrikane, të

cilët janë kuruar me ilaçe të falsifikuara, të blera edhe shtrenjtë. Sipas të dhënave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, 30% e ilaçeve që shiten në Afrikën sub-saharane, në Juglindjen aziatike dhe në Amerikën Latine janë fallo. Kreu i dikasterit vatikanas për shëndetësinë i ftoi farmacistët katolikë të denoncojnë pa frikë situatën tilla. Ja ç'tha vetë imzot Zigmunt Zimovski, në mikrofonin e Radio Vatikanit: në muajin shkurt të vitit të ardhshëm, Këshilli Papnor për Baritorinë e Shëndetit do të krenutojë 25-jë garanton jetën. Shpesh, për motive ekonomike, nuk kurohen sëmundje tipike të vendeve në zhvillim, sepse, megjithëse u shkaktojnë vdekjen miliona njerëzve, nuk përbëjnë një treg të pasur. Disa nga këto ilaçe mund të realizohen lehtë mbi bazën e njohurive aktuale shkencore, por nuk e shohin dritën e dëlclit për motive tjesh ekonomike, pasi të sëmurët nuk kanë mundësi të mjaftueshme për t'i blerë. Duket qartë – theksoi imzot Zimovski – se zhvillimi i ilaçeve nuk qeveriset më nga etika tradicionale e mjekësisë, por nga logjika e industrisë".

Imzot Miliore në OKB:

personi, pasuria më e madhe e botës

Sfidat e shumta para bashkësisë ndërkombëtare për të arritur në një zhvillim më të madh e më të qëndrueshëm ekonomik e shoqëror – kjo ishte tema e fjalimit që mbajti Vëzhguesi i Përhershëm i Selisë së Shenjtë në OKB, imzot Çelestino Miliore, në Asamblenë e përgjithshme, që u mbajt në Pallatin e Qelqit në Nju Jork.

Demografia, familja, promovimi i gruas, emigracioni, arsimit, shëndeti i nënës dhe i fëmijës: të shumta çështjet e rëndësishme për të ardhmen e njerëzimit, 15 vjet pas Konferencës së Kajros mbi popullsinë e zhvillimin.

Nëse në vitin 1994 – kujtoi prelati – të gjithë mendonin se ishim përpara një shpërthimi demografik, që do të pengonte zhvillimin global, sot shohim se kjo përshpikje ishte e pabazuar. Zvogëlimi dhe

plakja e popullsisë në shumë vende të zhvilluara kërkon tani politika për rritjen e lindjeve, që të sigurohet mirëqenia ekonomike. Shumë vende, dikur të varfra, po zhvillohen me shpejtësi, të kërcënuar jo aq nga rritja demografike, se sa nga papërgjegjësia e qeverisjes ekonomike botërore dhe lokale. Për një shekull me radhë – nënvizoi imzot Miliore – janë bërë përpjekje për ta lidhur popullsinë me ushqimin, energjinë, burimet natyrore e krizat ambientale. Sot, shohim se në të vërtetë, janë personat pasuria më e madhe e botës. Po ashtu edhe familja, e cila njihet nga OKB-ja si element që nxit zhvillimin më të madh ekonomik e shoqëror. Sot, ajo duhet të përballojë sfidat e emancipimit të gruas në punë e në shtëpi, gjë, për të cilën është e nevojshme ndihma e qeverive.

E nëse personi është në qendër të politikave të zhvillimit – tha Vëzhguesi i Përhershëm i Vatikanit në OKB – ashtu janë edhe emigrantët, të cilët shpesh shihen si pasojë e pashmangshme e globalizimit dhe paragjykimet ndaj tyre përdoren për të nxitur politika shpesh çnjerëzore.

Së fundi, imzot Miliore theksoi se është e rëndësishme që të gjithë të marrin arsimin e duhur dhe nënvizoi qëndrimin e Selisë së Shenjtë kundër abortit, si mjet për planifikimin familjar.

Marrë nga Radio Vatikani

Mateu – tagrambledhës

Në personin e Mateut Ungjilltarë ne takojmë një person paradoks: i cili duket se është larg prej shenjtërisë, por në anën tjetër ai mund të jetë shembull për njerëzit, i cili është i gatshëm për të pranuar mëshirën Hyjnore dhe mund ta lejon veprimin e tij në mënyrë të mrekullueshme në jetën e tij.

■ PËRGATITI:
Don Marjan MARKU

Rendi i portreteve të 12 Apostujve, të cilin e kemi nisur ta paraqesim në pika të shkurtra në revistën tonë "Drita", na sjell deri tek Mateu. Në Ungjill në realitet kemi shumë pak lajme për jetën e tij dhe kështu nuk është shumë e lehtë që të bëhet një portret për të.

Në rend të parë, është i shënuar në listën e 12 apostujve, të cilët Krishti i ka zgjedhur (Mt 10,3; Mk 3,18; Lk 6,15; Apg 1,13). Emri Mate është emër hebraik dhe domethënie

»Dhuratë e Hyjit«. Ungjilli i parë, i cili e bart emrin e tij, na tregon realitetin e profesionit të tij, ai ishte tagrambledhës (Mt 10,3).

Në këtë kuptim identifikohet me njeriun, i cili qëndronte në doganë kur Jezusi e thirrri që të shkonte pas tij: »Jezusi, si shkoi prej andej, pa një njeri që quhej Mate, ndenjur në doganë. Jezusi i tha: Eja mbas meje! Ai u ngrit dhe shkoi pas tij« (Mt 9,9). Po ashtu edhe Marku (krah. 2,13-17) por edhe Luka (krah. 5,27-30) na lajmërojnë për thirrjen e Mateut i cili rrinte në doganë, por ata e quajnë atë »Levi«. Nga Ungjilli del dhe një detaj tjetër biografik për Mateun: Para thirrjes së Mateut na paraqitet një mrekulli, të cilën Krishti e kishte bërë në Kafarnaum (krah. Mt 9,1-8; Mk 2,1-12), dhe aty ceket se kjo mrekulli kishte ndodhur në afërsi të liqenit të Galileës, apo të Tiberiadit (krah. Mk 2,13-14). Kjo na mundëson që të kuptojmë se Mateu detyrën e vet si tatimtar e kryente në Kafarnaum, dhe ky qytet gjendej afër liqenit« (Mt 4,13), ku Jezusi shpesh ishte mysafirë në shtëpinë e Pjetrit.

Në bazë të kësaj dëshmie të thjeshtë të cilën na sjell Ungjilli mund t'i bëjmë disa përfundime. E para është se Jezusi në listën e 12 nxënësve apo bashkëpunëtorëve të tij e pranon një person, i cili në sy të izraelitëve ishte mëkatarë apo hajn i përhershëm. Mateu nuk kishte punë vetëm me para por edhe me popull i cili nuk i takonte popullit të Hyjit, po ashtu ai bashkëpunonte me njerëz të huaj apo armiq të cilët mblidhnin tatimin.

Nga ky aspekt, në ungjill i takojmë disa herë tagrambledhësit si mëkatar« (Mt 9,10; Lk 15,1) po ashtu edhe si lavir« (Mt 21,31). Nga ky aspekt tagrambledhësit

quhen edhe njerëz me zemër të ngurtësuar (krah. Mt 5,46), ata i duan vetëm ata, të cilët i duan dhe ishin të pasur siç ishte edhe Zakeu, »kryetar i tagrambledhësve... ishte shumë i pasur (Lk 19,2), ndërsa sipas mendimit të njerëzve tjerë ata ishin hajna, mashtrues, thyes kurorash« (krah. Lk 18,11).


Nga ky aspekt, shihet një gjë shumë qartë se Jezusi nuk e përjashton askënd për të qenë mik i tij. Në të kundërtën, kur ishte ulur në tryezë në shtëpinë e Mateut-Levit, kishin filluar që ta qortonin dhe të falnin kundër tij, ndërsa Jezusi u përgjigj: »Mjeku nuk u dubet të shëndoshëve, por të sëmurëve. Nuk erdha të grish të drejtët, por mëkatarët« (Mk 2,17).

Lajmi i gëzueshëm i Ungjillit qëndron në mundësinë e pranimit të hirit të Hyjit për mëkatarë. Në një rast tjetër Jezusi na paraqet shembëlltërinë e njohur të fariseut dhe tagrambledhësit, të cilët u ngjiten në tempull për tu lutur, fariseu qiri në këmbë lutej kështu: »Të falënderoj o Hyj që nuk jam pors i njerëzit tjerë: cuba, të padrejtë, kurorëshkelës.... Agjëroj dy herë në javë, jap lëmosh, ndërsa tagrambledhësi zuri vend në fund, nuk i bëhej as sytë t'i ngrejë drejtë qiellit, por rribte krabaronin e vet e thoshte: O Hyj, ki mëshirë për mua mëkatarin! Unë po ju them: ky u kthye në shtëpinë e vet i shfajësuar e ajo ai, sepse: kushdo krenohet do të përvuajtërohet, ndërsa kush përvuajtërohet, do të lartësohet« (Lk 18,13-14).

Në personin e Mateut Ungjilltarë ne takojmë një person paradoks: i cili duket se është larg prej shenjtërisë, por në anën tjetër ai mund të jetë shembull për njerëzit, i cili është i gatshëm për të pranuar mëshirën Hyjnore dhe mund ta lejon veprimin e tij në mënyrë të mrekullueshme në jetën e tij.

Një mendim tjetër, i cili i përgjigjet paraqitjes biblike është përgjigjja e menjëhershme e Mateut në thirrjen e Jezusit: »Mateu u ngrit dhe shkoi pas tij«. Shkurtesa e kësaj fjalie e tregon gatishmërinë e qartë të Mateut për të përgjigjur në thirrjen e Jezusit. Kjo për Mateun domethënë, me i lanë gjithçka, para së gjithash edhe gjithë të ardhurat e tij, të cilat ia sigurojnë ekzistencën jetësore edhe pse nganjëherë parat që i merrnin ishin të paligjshme. Me siguri se Mateu ka kuptuar se besimi në Jezusu Krishtin nuk e lejon të

“Mjeku nuk u duhet të shëndoshëve, por të sëmurëve. Nuk erdha të grish të drejtët, por mëkatarët” (Mk 2,17).”



merret më me ato aktivitete me të cilat është marr deri më tani.

Po ashtu edhe sot nuk është i lejuarshëm fitimi i paligjshëm apo fitimi i cili nuk përputhet me ligjin e Hyjit. Një herë Jezusi tha: »Nëse do të jesh i përsosur, shko, shit çka ke, falja skamnorëve e ke për të pasur visar në qiell, pastaj eja e më ndiq mua« (Mt 19,21). Të njëjtën gjë bëri edhe Mateu: U ngrit dhe

shkoi pas tij! Në këtë rast mund ta shohim fjalën »u çua« duke e lënë situatën e tij mëkatore dhe në të njëjtën kohë me qenë i vetëdijshëm dhe i gatshëm për një jetë të re, në një jetë të vërtetë në bashkësi me Jezusin.

Në fund duhet përkujtuar, se tradita e Kishës së vjetër na tregon se Mateu ka shkruar ungjillin e parë. Për këtë na njofton Papias

i cili ishte ipeshkëv në Hierapolis në Frigi në vitin 130.: »Mateu i ka përmblledhur fjalimet në gjuhën hebreje; të njëjtat duke e përkthyer aq sa mirë dinte« (in: Eusebius von Caesarea, Kirchengeschichte, III, 39). Historiani Eusebius e bashkëngjiti edhe këtë: Mateu, i cili më së pari predikonte tek hebrejtë, shkroi se dëshironte të shkonte edhe tek popujt tjerë.

Lutja në shembullin dhe në mësimet e famullitarit të shenjtë të Arsit

Njeri i pajtimit, Shën Gjon Maria Vianney kishte kup-tuar që *“meshtari para së gjithash duhet të jetë njeri i lutjes”*. Çdo njeri nje netët e gjata të adhurimit, që famullitari i ri i një fshati, atëherë pak i krishterë, i kalonte përpara të Shenjtërueshmit Sakrament. Tabernakulli i Kishës së tij bëhet shpejt vatrë e jetës së tij personale dhe e apostullatit të tij, deri në atë pikë ku nuk mund të thirrjet më mirë famullia e Arsit në kohën e Shenjtë, apo me këtë shprehje të Piu XII mbi famullinë e krishterë: *“Qendra është kisha, e në kishë Tabernakulli me rrëfjostoren; ku gjëjnë jetën shpirtitrat e vdekur dhe të sëmurit rrijtojnë shenjtërinë”*.

Meshtarëve të këtij shekulli, shumë të ndjeshëm në efikasitetin e veprimit dhe të shpejtë në tundim nga një aktivitet i rrezikshëm, sa është për ta përshëndetur këtë model të lutjes së ngultë në një jetë thellësisht të kushtuar nevojës së shpirtitrat! *“Ajo që na ndalon neve meshtarëve të jemi shenjtër – thoshte ai – është mungesa e meditimit; po nuk hyrë në vetvete; nuk di çka bën; na është i nevojshëm reflektimi, lutja, bashkimi me lutjen e vazhdueshme, e cila nuk e tërhiqte vëmendjen as lodhja e rrëfjimeve e as detyrat tjera pastorale”*. *“Ruante një bashkim konstant me Zotin nëpërmjet jetës së tij punëtore”*.

Ta dëgjojmë ende atë. Ai është i pashtershëm kur flet për gëzimet dhe të mirat e lutjes. *“Njeriu është aq i varfër, sa që ka nevojë të pyesë gjithçka Zotin”*. *“Sa shpirta mund t'i kthejmë me lutjet tona!”* dhe përsëriste: *“Lutja është pra gëzimi i njeriut mbi tokë”, ky gëzim shijohet vazhdimisht nga ai vetë, ndërsa shikimi i shndritur nga feja sodiste misteret hyjnore nëpërmjet adhurimit të Fjalës së mishëruar, e lartësonte shpirtin e tij të thjeshtë e të pastër drejt të Shenjtërueshmit Trini, objekt më i lartë i dashurisë së tij. Dhe shtegtarët, të cilët ngarendnin në Kishën e Arsit, kuptonin që meshtari i përvojatur u dëshmon-te atyre diçka sekrete të jetës së tij të brendshme me atë dëshmi që shpesh i pëlqente ta përsëriste: *“Të jesh i dashur nga Zoti, të bashkohesh me Zotin, të jetosh në praninë e Zotit, të jetosh për Zotin: oh! Sa jetë e bukur e sa vdekje e bukur!”*.*

Meshtari në rend të parë është njeri i lutjes

Ne dëshirojmë, meshtarë të dashur, që të gjithë meshtarët e dioqezave tuaja të jenë të tërhequr nga dëshmia e famullitarit të shenjtë të Arsit, nga nevoja të jemi njerëz të lutjes dhe të mundësive për të bërë, çfarëdo që është barra apo në zhytjen e skajshme të ak-



“**Është pra e nevojshme që shpirti meshtarak të përpiket të prodhojë në vetë atë që benë në altar të sakrificës: sikur pra Jezu Krishti e flijoi vetveten, ashtu edhe ministri i tij së bashku me të ta flijojë vetveten; sikur Jezusi i mori mëkatet e njerëzimit, ashtu edhe meshtari duhet të arrij në pastrimin e vetvetes dhe të tjerëve nëpërmjet vështirësisë së arritjeve të krishtera.**”

tiviteteve në minister. Por është e nevojshme një fe e gjallë, si ajo që na nxit shenjtë i Arsit dhe e bënte për të bërë mrekulli: *“Çfarë feje! – thoshte njeri nga bashkëvëllezërit e tij –. Të ai ka çka të pasurohet një dioqezë!”*.

Kjo besnikëri në lutje është për meshtarin një detyrë e përshtirësisë personale, që urtia e Kishës e ka saktësuar nëpërmjet pikave të ndryshme, sikur lutja mendore e përditshme, vizita e Shenjtërueshmit Sakrament, Rruzarja dhe rrërimi i ndërgjegjes. Dhe është një obligim i rëndësishëm përpara Kishës, kur bëhet fjalë për recitim të përditshëm të Breviarit. Ndoshta për arsye që janë mënjauar nga shkujdesi ynë, këto përshkrime për disa pjesëtarë të klerit janë të shikuara si viktime të paqëndrueshmërisë së jashtme, të brejtjes së brendshme dhe të ekspozuar një ditë pa mbrojtje

përpara tundimeve të jetës. Në të kundërtën, *“duke punuar për të mirën e shpirtitrat, Gjon Maria Vianney nuk shkujdesej as për të vetën. Shenjtëronte vetveten për të genë i aftë t'i shenjtërojë të tjerët”*.

Mëshira eukaristike e famullitarit të shenjtë të Arsit

Lutja e famullitarit të shenjtë të Arsit, që kaloi tridhjetë vitet e fundit të jetës së tij në kishë, ku e mbanin pendestarët e panumërt, ishte mbi të gjitha një lutje eukaristike. Devotshmëria ndaj Zotit të pranishëm në të Shenjtërueshmin Sakrament, në altar, ishte vërtetë e jashtëzakonshme: *“Është aty – thoshte – Ai që na do shumë; pse nuk duhet ta duam edhe ne?”*. Natyrisht ai donte dhe e ndjehej në mënyrë të parëzistueshme i tërhequr ndaj tabernakullit: *“Nuk ka nevojë të flasësh shumë për t'u lutur mirë – shpjegonte ai famullisë së vetë –. Dihet se Zoti i mirë është*

aty, në Tabernakullin e shenjtë; i bapet zemra, dubej gëzuar pranisë së tij. Kjo është lutja më e mirë”. Në çdo rrethanë ai thërriste besimtarët në respekt e dashuri ndaj pranisë hyjnore në Eukaristi, duke i ftuar t'i afrohen kungimit që ai e dëshmonte me shembullin e devotshmërisë së tij të thellë: *“Për t'i bindur – dëshmuar dëshmitarët e jetës së tij – mjaftonte ta shikonin kremtimin e Meshës së Shenjtë për të bërë gujëzimin kur kalonte përpara tabernakullit”*.

Rëndësia e Eukaristisë në jetën meshtarake

“Shembulli i famullitarit të shenjtë të Arsit ruan edhe sot tërë vlerën e saj”, thoshte Piu i XII. Asgjë nuk mund ta zëvendësojë në jetën e një meshtari lutjen në heshtje përpara altarit. Adhurimi i Jezusit, Zotit tonë, falënderimi, përmirësimi i fajëve tona dhe atë të tjerëve, thirrja për njeret e

shumta që na besohen, tërhiqen në ngritjen e këtij meshtari në një dashuri më të madhe ndaj Mësuesit hyjnor, të cilit i ka prem-tuar besnikëri, dhe për njerëzit që presin shërbesën meshtarake. Me praktikimin e një kultu të tillë, të shndritur e të zellshëm, ndaj Eukaristisë, rritet jeta shpirtërore meshtarake dhe përgatiten en-ergjitë misionare të apostujve më të vlefshëm e të aftë.

Dhe duhet shtuar të mirat që na vijnë për besimtarët, dëshmitarët e kësaj devotshmërie të meshtarëve të tyre dhe që janë të tërhequr nga shembulli i tyre. *“Nëse dëshironi që besimtarët të luten me vullnet e devotshmëri – thoshte Piu i XII, klerit të Romës – paraprini në kishë me shembull, duke u lutur në praninë e tyre. Një meshtar i gujëzuar përpara popullit, me qëndrim të denjë, i thel-luar në lutje, është një shembull i ndërtimit, një qortim dhe një thirrje në përpjekje gojore për popu-llin”*. Kjo ishte arma apostolike e famullitarit të ri të Arsit, mos të dyshojmë në vlerën e tij në çdo rrethanë.

Meshtaria dhe Sakrifika e Meshës Shenjtë

Nuk mund të harrojmë me-gjithatë që lutja eukaristike, në domethënie e plotë të fjalës, është Sakrifika e Shenjtë e Meshës. Duhet të insistojmë, të dashur vëllezër, veçanërisht në këtë pikë, sepse prek një aspekt qenësor të jetës meshtarake.

Nuk e kemi për qëllim të paraqesim këtu doktrinën tradi-cionale të Kishës ndaj meshtarisë dhe flijës eukaristike; paraardhësit tanë të dashur Piu XI e Piu XII, në dokumentet e magjisterit, e kanë thirrë me shumë qartësi këtë mësim që nuk na mbetet tjetër që t'u bëjmë të njohur meshtarëve dhe besimtarëve që na janë besu-ar. Kështu zhduken dyshimet apo mendimet provokuese që shpesh janë paraqitur përpara nesh.

Gëzojmë që nëpërmjet kësaj Enciklike të mund të dëshmojmë që me ndjenjën e thellë të famu-litarit të shenjtë të Arsit, besnik heroik, ndaj detyrave meshtar-ake, meritoi me të vërtetë të jetë i propozuar si shembull udhëheqësve të shpirtitrat dhe të shpallet pajtor i tyre. Nëse është e vërtetë që meshtari e ka pranuar karakterin në Shugurimin meshtarak për të shërbyer në altar, dhe e ka filluar ushtrimin e detyrës meshtarake me sakrificën eukar-istike, kjo nuk pushon, për tërë jetën, të jetë bazë e aktiviteteve apostolike dhe shenjtëritimit per-sonal. E pikërisht kështu ndodhi me rastin e Shën Gjon Maria Vianney.

“ Nëse dëshironi që besimtarët të lutën me vullnet e devotshmëri – thoshte Piu i XII, klerit të Romës – paraprini në kishë me shembull, duke u lutur në praninë e tyre. Një meshtar i gjunjëzuar përpara popullit, me qëndrim të denjë, i thelluar në lutje, është një shembull i ndërtimit, një qortim dhe një thirrje në përpjekje gojore për popullin ”

Cili është apostullati meshtarak, duke e konsideruar detyrën e tij esenciale, se jo ai që atë të zbatojë, në çdo vend ku është Kisha, bashkimi rreth altarit të një populli të bashkuar në fe, të ripërtëritë e të pastruar? Pikërisht atëherë meshtari, për atë pushet që vetëm ai e ka marrë, ofron flijën hyjnore në të cilën vet Jezusi ripërtëritë fljimin e vetëm të bërë në Kalvar për shëlbimin e botës dhe lavdinë e Atit. Atëherë të krishterët të bashkuar i ofrojnë Atit Hyjnor Flijën hyjnore nëpërmjet meshtarit dhe mësojnë të flijojnë vetveten si “*hostie të gjalla, të shenja e të pëlgjeshme Zotit*” (Rm 12,1). Aty është, që populli i Zotit, i shndritur nga predikimi i fesë, ushqehet me Korpin e Krishtit, e gjejnë jetën e tyre, bëhet rritja, e nëse është e nevojshme përfundon unitetin. Aty janë në një fjalë të vetme gjeneratë pas gjeneratë, të gjitha plagët e botës, ndërtohen në dashurinë e Trupit mistik të Krishtit e që është Kisha.

Për sa i përket kësaj, famullitari i shenjtë i Arsit u bë ditë pas ditësh më i angazhuar në mësimin e fesë e në pastrimin e ndërgjegjes, ndërsa të gjithë veprat ministeriale bëhen nga altari, sa që jeta e tij është meshtarake e pastorale. Është e vërtetë që në Ars mekatarët shkonin në mënyrë spontane në Kishë, të tërhequr nga fama e shenjtërisë së famullitarit, ndërsa shumë meshtarë të tjerë duhet të angazhohen përpjekje të shumta e të gjata për të bashkuar grigjinë e tyre; është e qartë edhe se të tjerët e kanë një detyrë misionare, dhe gjenden në fillim të laimit të Gëzueshëm të Shëlbimit; këto punë apostolike, megjithatë, shumë të nevojshme edhe të vështira nuk mund të bëjnë që meshtarët të harrojnë finalitetin në të cilën duhet të drejtohen dhe në të cilën na dërgon famullitari i shenjtë i Arsit, ku në kishën e tij të përvuajtur malore, i kushtojë detyrave themelore të veprës pastorale.

Mesha e Shenjtë, burimi i parë i shenjtërimin personal meshtarak

Ka edhe më shumë. Tërë shenjtërimi personal i meshtarëve duhet të modelohet në sakrificën që kremojmë, i njëjtë me thirrjen papnore “*Njiheni atë që bën; imitojeni me atë që ushqehet*”. Por t’ia lëmë fjalën këtu edhe paraardhësit tonë në Thirrjen “*Menti nostrae*”:



“Sikur tërë jeta e Shpëtimtarit tonë ishte në funksion të sakrificës së tij, kështu edhe jeta meshtarake, duhet të prodhojë në vete figurën e Krishtit, duhet të bëhemi sikur ai, në të dhe për të një sakrificë mirënjohëse... Pra nuk duhet vetëm kremtuar sakrificën eukaristike, por, në një mënyrë të thellë, të jetohet; në këtë mënyrë mund të marrim pjesë në atë forcë mbinatyrore, nga e cila shndërrohemi në mënyrë intime e marrim pjesë në jetën e flijimit të vet Shëlbuesit tonë”. Po i njëjti Papë përfundonte: “Është pra e nevojshme që shpirti meshtarak të përqipet të prodhojë në vete atë që benë në altar të sakrificës: sikur pra Jezu Krishti e flijoi vetveten, ashtu edhe ministri i tij së bashku me të ta flijojë vetveten; sikur Jezusi i mori mëkatet e njerëzimit, ashtu edhe meshtari duhet të arrijë në pastrimin e vetvetes dhe të tjerëve nëpërmjet vështirësisë së arritjes të krishterë”.

Kisha e ka prezant këtë doktrinë të lartë kur thërrret ministrat e vet në një arritje dhe i porosit ata të kremojnë me përsëritje të thellë sakrificën eukaristike. Nuk është ndoshta e kuptuar mirë lidhshmëria që qëndron dhe gati reciproke, që bashkon dhuratën e

përditshme të vetvetes në ofertën e Meshës, që disa meshtarë kanë arritur ngadalë ta humbin “*prima caritas*” të Shugurimit të tyre? Kjo ishte përvoja e bërë nga famullitari i shenjtë i Arsit: “*Shkaku – thoshte – i shthurjes së meshtarit është nga moskujdesi ndaj Meshës*”. Është shenjtë që kishë heroizmin “*e zakonsbëm të ofrojë sakrificën për mëkatet*”, lëshonte lot “*duke menduar prapësitë e meshtarëve që nuk i përgjigjesin shenjtërisë së thirrjes së tyre*”.

Me dashuri atërore, ne kërkojmë nga meshtarët tanë të dashur të bëjnë një kontrollim e shqyrtim se si e kremojnë meshën, dhe sipas dispozitave shpirtërore, me të cilat ngjiten altar dhe me frytet që përpiqen, t’i fitojnë. Njëqindvjetori i këtij shenjtë të admirueshëm që kishte një “*ngushëllim në kremtimin e Meshës*” me guxim të flijimit të vet, na thërrret që të kemi besim që ndërmjetësimi i tij të sjellë hire të mjaftueshme të dritës dhe fuqisë.

(Marrë nga enciklika “*Sacerdotii Nostri Primordia*” e Papa Gjoni XXIII)

Një nxitje për të rritur zellin dhe dëshirën për shenjtërinë tonë dhe “shpëtimin e shpirttrave”

Të dashur meshtarë,


në vitin kushtuar meshtarisë na ofrohet një mundësi e madhe për ripërtëritjen e besnikërisë dhe të dashurisë ndaj Krishtit dhe Kishës, për të gjetur vetveten në shërbime dhe fljime. Kjo thirrje na detyron në një koherencë të plotë me historinë tonë personale dhe komunitare, kuptohet, përbrenda ndryshimeve shpeshherë të nevojshme, të detyrueshme, të pashmangshme, të cilat mund të shkaktojnë edhe çështje kërkimi, krize, shqyrtimi, por gjithnjë në shoqëri me Zotin dhe me Kishën, Mësuesen dhe Nënë tonë.

Ju thërras që ky vit të mos jetë i kotë, por për të gjithë ne një arsye për të rilexuar jetën ministeriale që na është besuar, për t’i njohur zhvillimet nëpërmjet kohës dhe vendeve të shërbimit tonë meshtarak. Kështu do t’i gjejmë motivet e frymëzimit që na kanë udhëhequr gjatë viteve tona meshtarake: për të qenë të aftë për të drejtuar Popullin e Zotit në rritje, pjekuri dhe në shenjtëri me fuqinë e fesë, me ngjalljen e shpresës dhe me dhe ripërtëritjen e dashurisë në Fjalën e Mishëruar –Jezusin, Shëlbuesin dhe Kryepriestin tonë.

Dëshiroj që në këtë kohë, përbrenda meshtarëve, të mund t’i shprehim, me liri dhe besim të gjitha vështirësitë që jemi duke i përjetuar, si në nivelin personal, po ashtu edhe përbrenda bashkësive famullitare. Kështu që nëpërmjet këtij viti t’i qartësojmë rënjet e vështirësive, të cilat na bëjnë të frikësuar, të preokupuar. Në të njëjtën kohë është mirë të dëshmojmë edhe përvojat tona, më tërë thjeshtësinë me të cilën na frymëzon edhe Shën Gjon Maria Vianney, për veprat e mrekullueshme, që Zoti i bënë nëpërmjet nesh, shërbimeve tona, që shumë njerëz t’ia “lejojnë” Zoti takimin, afrimin, bashkimin dhe bashkëpunimin me të.

Të punojmë sidomos në “*conversio personale*” dhe në “*conversio pastorale*” që na ndihmojnë t’i gjejmë motivet e detyrave apostolike me më shumë përcaktim dhe besnikëri ndaj Krishtit dhe Kishës, si kusht thelbësor për të ndihmuar se pari vetveten, pastaj edhe bashkësitë që na janë besuar, për të qenë “misionarë” kudo dhe gjithnjë nëpërmjet kumtimit dhe dëshimit të Ungjillit, dëshmisë së jetës së krishterë.

Ta ndihmojmë njëri-tjetrin



për të arritur në kthimin e shumëfishtë: njerëzor, shpirtëror, meshtarak dhe baritor, aq i nevojshëm për të qenë “ndërtimtarët e Kishës” sipas shembullit të Krishtit, i cili është model i Bariut të grigjës se besuar.

Në këtë shembull, mbrojtës dhe pajtor e kemi Shën Gjon Maria Vianney, në ndarjen e sakramenteve, e në veçanti në kremtimin e Sakramentit të Dashurisë – Meshës së Shenjtë, si dhe atë të rrëfimit apo të pajtimit. Ky shembull i jashtëzakonshëm i Shën Gjon Maria Vianney, na ndriçon dhe na vjen afër në mënyrë madhështore edhe prej përvojës shpirtërore të udhëheqësve dhe kryebarinjve të Kishës, duke filluar prej letres së Atit shenjt Benedikt XVI, pastaj letra-enciklikë e Papës se Mirë – Gjoni XXIII, deri tek letra e Gjoni Palit II drejtuar meshtarëve me rastin e enjtes se madhe në vitin 1986.

Edhe pjesa biografike dhe lutja e rruazave dhe e litaneve me Shën Gjon Maria Vianney, e përmbledhur në këtë tekst, do të jetë një kontribut dhe një ndihmesë e madhe për të jetuar sa më shenjtërisht këtë vit të shenjtë meshtarak.

Prandaj këto tekste, të përthyerja e të përmbledhura në gjuhën tonë të dashur shqipe, le të jenë për meshtarët, rregulltarët dhe rregulltarët një oazë shpirtërore, një rast meditimi dhe reflektimi mbi veprat e mëdha që Zoti i ka realizuar nëpërmjet jetës dhe shërbimit të Shën Gjon Maria Vianney, si dhe një nxitje për të rritur zellin dhe dëshirën për shenjtërinë tonë dhe “shpëtimin e shpirttrave”.

Ipeshkvi i juaj
Mons. Dodë Gjergji
Prizren, Gusht 2009

350 vjet Dashuri të Krishterë dhe Mision

■ SHKRUAJNË:
Motrat vinçenciane

27 Shtatori 2009 hareshëm shënoi për Familjen Vinçenciane universale dhe për atë të botës shqiptare, hapjen e Vitit Jubilar të 350-vjetorit të vdekjes së Shën Vinçenc de Paul dhe Shenjtës Luiza de Marillac.

Dëshira jonë është, që, këto dy ikona të Dashurisë së Krishterë, të bëhen edhe më të njohura në mesin e popullit tonë shqiptar.

Shën Vinçenc de Paul është një ndër shenjtërit më të popullarizuar të Francës. Fryma e tij gjallëron edhe sot tek qindra e mijëra burra e gra, ndërsa vepër e tij vazhdon në Institucione e Kongregata të forta që ai i ka themeluar.

Asgjë nuk ishte e paracaktuar, që zotëri Vinçenci një ditë do të bëhej prift i vlerësuar nga e gjithë bota. Ndikues tek të mëdhenjtë e Mbretërisë, nismëtar dhe organizator i kryqëzatare bamirëse për lehtësimin e mjerimit të madh.

Ky bir i fshatarit të varfër Jean De Paul nga Pouy afër Daxit në krahinën Landeze lindi më 24 prill 1581 si fëmija i tretë ndër gjashtë fëmijë.

Fëmijët e asaj kohe nuk kishin kohë të zbaviteshin, ata dërgoheshin nga prindërit të kullotnin bagëtinë, edhe Vinçenci ishte bari delesh, lopësh e thish. "Isha bari derrash" theksoi ai vetë në fund të jetës së tij.

Pasi mbaroi studimet e teologjisë në Toulouse, u shuguroi prift në moshën 19-vjeçare më 23 shtator 1600 dhe pas disa vitesh ai shkroi: "Po ta kisha ditur sikur e di tani se ç'është meshtaria, sa do të kisha druajtur të hyja në të".

Vinçenci do të kishte mundësinë ta ndiqte një karrierë të ndershme kishtarë, duke mblodhur lëmoshat e duke e bërë një jetë jo fort të spikatur.

Por Hyji vë dorë në të. Nëpër rrugë të lakuara, i duhej të bënte e të ndërmerre vepër të mëdha për shërbim të bashkëkohësve të tij e të Kishës, e cila luftonte me rrymën janseniste.

Sa fusha të jetës në Kishë i shënjoji ai! Hapi seminare dhe punoi për formimin e priftërinjve, kurse për ungjillëzimin e fshatrave ai themeloi më 25 janar 1625 Kongregatën e priftërinjve të Misionit, ndryshe të quajtur edhe lazarishtë, pasi me 23 gusht

1617 e ngriti Shoqatën e Zonjave të Dashurisë së Krishterë, më 29 nëntor 1633 në bashkëpunim me Luizën de Marillac u bë themelues i Kongregatës së Bijave të Dashurisë së Krishterë për shërbimin trupor dhe shpirtëror të të varfërve.

Që nga arritja e tij në Paris në vitin 1608 deri në ditën e vdekjes së tij me 27 shtator 1660 Vinçenci beri shumë eksperiencë të shërbimit kishtar duke filluar me shpërndarjen e lëmoshave të mbretëreshës Marguerite de Valois, nga ku pastaj kalon për një vit famullitar në Clichy.

Nga Pierre de Berulle themelues i Kongregacionit të Oratorit, i cili gëzonte prestigj të madh si në botën kishtarë po ashtu edhe në oborrin mbretëror, u dërgua për edukim të fëmijëve të Philippe-Emanuel de Gondi gjeneral i anijeve mbretërore dhe për drejtim shpirtëror të gruas së tij Zonjës de Gondi.

Me të gjitha këto punë Vinçenci nuk e gjeti lumturinë dërrisa nuk iu përkushtua Zotit për shërbim të të varfërve shpirtërorë, që Zoti ia zbuloi në pronat e de Gondëve, kur një njeri i vlerësuar për të mirë nga i tërë fshati ishte në prag të vdekjes kërkon rëfimin e fundit e më pas dëshmon se pa këtë rëfim do të ishte i dënauar me bjerrje të pasosur, sepse kishte pasur mëkatë që nuk i kishte rrëfyer kurrë më parë. Bëhet pyetja, po gjendja shpirtërore e të tjerëve si mund të jetë?

Pas pak kohësh Zoti i zbulon Vinçencit dhe të varfrit trupor në Chatillon les Dombes, ku një familje e tërë ishte e sëmurë dhe në varfëri të skajshme pa qenë e ndihmuar prej askujt.

Këto dy fakte u bënë pikënisje dhe pikësynim i jetës së Vinçencit dhe i tërë familjes Vinçenciane, e cila sot përbëhet nga shumë degë të ndryshme dhe është e përhapur në të gjitha kontinentet.

Një shikim i vëmendshëm mbi jetën e zotëri Vinçencit tregon se ky, i cili në shekullin XVII ishte "Ministër i Dashurisë së Krishterë", mbetet mësues prej ne, në të kuptuarit e Ungjillit dhe të dashurisë efektive të Krishtit "Ungjillëzuesit të të varfërve".

"Dashuria është krijuese në pafundësi" tha Shën Vinçenci dhe e jetoi këtë deri në fund të jetës së tij.

Vdiq më 27 shtator 1660, ndër-



sa u kanonizua në vitin 1737 nga papa Klementi XII. Kurse papa Leoni XIII e shpalli si Pajtor të përgjithshëm të veprave të Dashurisë së Krishterë në vitin 1885.

Nëse lexoni për Vinçenc de Paul do të zbuloni një njeri me mendjemprehtësi dhe mirësi të madhe, një njeri realist dhe me vizion të largët, një njeri të shquar pune. Do të zbuloni edhe një njeri të Zotit, të përvuajtur, të vëmendshëm ndaj ftesave të Shpirtit Shenjt, dhe që ecte në hap me Provaninë Hyjnore, në pasionuar nga dashuria e Jezu Krishtit, një shenjt i vërtetë i kohës postmoderne. Do të jeni të lumtur nëse do të qëndroni për një çast në shoqërinë e tij.

Të shikojmë portretin e Shenjtës Luiza de Marillac.

Shpeshherë simpatia për një person varet nga portreti, që i kanë bërë të tjerët. Në rastin e Luizës, brezat e kaluara na kanë dhënë një figurë të zbehtë, të ven-

itur, na kanë paraqitur një grua të dobët, të pasigurt, të pavendosur, të brishtë, të ngashërve.

Kush e ka njohur Luizën ka pasur mundësi për të soditur shikimin e saj plot me dritë dhe sytë e saj shumë shprehës. Calvet thotë: "Luiza ishte e bukur si të gjithë ata që i përkisnin familjes De Marillac." Nga familja De Marillac Luiza do të trashëgojë edhe ndjenjën e mprehtë për nderim, zellin ndaj punës, vulltin, shpirtin mistik e shumë cilësi tjera.

Portreti tregon një fytyrë të rregullt me një vijë vezake shumë të pastër. Sytë ishin original dhe shprehës, goja e vogël me buzë të holla, mjekra ishte e dalë dhe vullnetforte.

Shenja Luiza de Marillac pati një jetë krejt ndryshe nga ajo e Shën Vinçencit. Ajo vinte nga një familje fisnike dhe shumë e njohur në Paris me funksione të larta në oborrin mbretëror dhe në armatën franceze. Sot nëpër mbarë botën shumë vajza, gra, nëna, të veja, të shtresave të ndryshme shoqërore gjejnë në Shenjtën Luiza modelin dhe mbështetje për t'i përballuar sfidat dhe vështirësitë e jetës.

Luiza de Marillac u lind me 12 gusht 1591. Vendi i lindjes së saj nuk dihet. Por është e mundshme që nëna e saj jetonte në Paris.

Luiza de Marillac nuk e njohu kurrë ëmbëlsinë e nënës, nuk do të takohet kurrë as me ngrohtësinë e vatrës familjare. I ati i saj Luigj de Marillac, i lindur në vitin 1556, në çastin e lindjes së Luizës ishte i vejë nga vdekja e gruas së parë e cila nuk i la fëmijë. Cila është nëna? Askush nuk e di, dhe askurrë askush nuk do ta dijë. Dëshmia e pagëzimit të Luizës, nuk është mundur të gjendet, sepse shumë regjistra të shekullit XVII janë zhdukur.

Babai i Luizës martohet për të dytën herë me 15 janar 1595. Merr për grua Antoinette Le Camus, një veshje, nënë e tre fëmijëve.

Në moshën 13-vjeçare, Luiza takohet me një vuajtje tjetër. I vdes i ati më 25 korrik 1604. Luigj de Marillac e donte thellësisht të bijën e vet. Në testamentin e tij ai shkruan «Se ajo ia kishte dhënë ngushëllimin më të madh në botë, dhe se ai besonte, që ajo ishte dhuratë e Hyjit për qetësimin e shpirtit të tij në pikëllimet e jetës».

Me të gjitha vuajtjet që e shënjuan personalitetin e saj të ri, Luiza ia arriti shenjtërisë. A nuk është ky një mesazh që Hyji na drejton duke na zbuluar kështu, se çdo fëmijë i plagosur nga jeta mund të bëjë diçka të mirë, mund të lulëzojë e mund të arrijë në një shenjtëri të vërtetë?

Në moshë shumë të njomë Luiza de Marillac iu besua rregulltare Dominicanë të kuqëndit mbretëror në Poissy. Ky kuqëndi i themeluar nga Mbreti i shenjtë Ludoviku IX pranonte disa fëmijë të vegjël fisnikësh për t'iu dhënë atyre një edukim, që përputhej me rangun e tyre në shoqëri.

Pranë motrave Dominicanë Luiza mëson të lexojë, të shkruajë, studion gjuhën latine e është e mundur që edhe atë greke. Ajo merr aty njohuri për pikturë dhe për muzikë. Në Poissy ajo takohet me dashurinë e fortë dhe të thellë të njërës prej hallave të saj, Nënës Luizë de Marillac.

Pas vdekjes së të atit, ungjit e Luizës e largojnë nga kuqëndi dominikan, ku ajo edukohet dhe e vendosin në një familje pranë një gruaje të shkathët, e cila do ta mëson Luizën të bëjë punë të ndryshme dhe të përshtatshme për rrethanat e saj. Këtu ajo merr një edukim praktik, mëson gatimin, pastrimin, qepjen e çdo gjë që është e nevojshme të dijë një femër. Me këtë edukim Hyji e përgatiti Luizën për detyrën e saj të ardhshme si formuese e Motrave dhe si themeluese e Kongregatës. A nuk është ky një mesazh tjetër që Hyji na drejton, duke na ftuar të zbulojmë në çdo ngjarje shenjat e Dashurisë së Tij?

Në vitin 1606 në Luizën 15-vjeçare i zgjohet apo i rizgjohet dëshira për t'iu kushtuar Hyjit tek Rregulltaret Kapuçine. Ajo bën kushtin që t'i kushtohet



Hyjit, që sipas mendimit të asaj kohe për Luizën ishte një mënyrë që ta fitonte drejtësinë e Hyjit dhe ta përmirësonte gabimin e të atit të vet në kohën e lindjes së saj. Mirëpo përgjigja e Atit provincial është shumë e çartë dhe e prerë. Luiza me shëndet të dobët, nuk do të mund ta bartë vrazhdësinë e Rregullores. Ajo nuk është e thirrur për këtë jetë të mbyllur tek Kapuçinet. Dhe Ati provincial qoftë për ta ngushëlluar vajzën e re qoftë nga frymëzimi i Hyjit e mbyll bisedën me këto fjalë: «Hyji ka plane të tjera me ju».

Për t'ia larguar asaj mërzinë dhe mendimet për jetën rregulltare dërgohet tek halla për t'i ndihmuar në rritjen e fëmijëve, ndërkohë vëllezërit e të atit dhe familjarët e tjerë shikojnë t'ia gjejnë një burrë të përshtatshëm.

Në moshën 22-vjeçare merr për burrë atë që ia kanë zgjedhur të afërmit. Anton Le Gras, 32 vjeçar, i cili i takonte borgjezisë, por jo aristokracisë, për këtë arsye Luiza nuk ka të drejtë të quhet zonjë, por zonjusha Le Gras. Në kontratën martesore, e cila bëhet më 4 shkurt 1613, edhe një herë sillen në kujtesë së Luiza de Marillac është fëmijë i paligjshëm i Luigi de Marillac, kështu që ungjit dhe hallat e pranishme për këtë akt zyrtar quhen "miqtë" e nuses. Martesës zyrtare i pasoi riti fetar në kishën e Shën Gervazit në Paris më 5 shkurt 1613.

Çifti i ri edhe pse nuk e kanë zgjedhur njëri-tjetrin kalojnë një jetë të lumtur bashkëshortore të mbështetur në lutje dhe në fjalën e Zotit për të cilën zonjusha Le Gras kishte marrë autorizimin nga Monsignor Camus që ta ketë Biblën në shtëpi dhe ta lexojnë në gjuhën e tyre frënge gjë që ishte e rrallë.

Në shtëpinë e çiftit Le Gras me 18 tetor 1613 vjen fëmija i dëshiruar, të cilin menjëherë të nesërmen e pagëzojnë me emrin Michel.

Gjatë kohës kur Anton Le Gras ishte i angazhuar në oborin mbretëror, Luiza merret me edukimin e të birit dhe me

punët e zonjës së shtëpisë. Detyrat e nënës dhe të gruas nuk e ndalojnë që t'u rezervonte një pjesë të kohës dhe të zemrës edhe të varfërve. Ajo i mirëpret në shtëpinë e saj, i viziton, dhe u jep ndihmë dhe ëmbëlsira.

Dhjetë vite kaluan kështu dhe në fund të tyre kryqi përsëri u vendos në jetën e Luizës, iu sëmur rëndë bashkëshorti, të cilin i shërbeu me përkushtim dhe me një durim të admirueshëm. Megjithatë, një natë e tmerrshme e pushtoi shpirtin e të shkrëtës Luizë. Dobësi i të shoqit i dukej si dënim i Zotit, që ajo nuk i ka qëndruar besnikë në premtimin e saj për t'u bërë rregulltare. Ajo shkon deri në atë pikë sa që mendon se duhet ta braktisë bashkëshortin. Feja e saj përplasat me dyshimet e tmerrshme mbi pavdekësinë e shpirtit. Nata e saj e brendshme e arrin dendësinë më të madhe në festën e Shëlbuemit, që ishte më 25 maj 1623. tundim e lëkundnin në besim ndaj jetës së amshuar e madje edhe në ekzistencën e Hyjit. Kështu Zoti e sprovi shërbëtores e vet, i cili do që ajo ta dojë atë me më të pastërtën dashuri.

Në ditën e Rrëshajve Luiza bartëse e këtij kryqi hyn në Kishën e Shën Nikollit. Aty kur ajo po lutej papritmas u pushtua nga një dritë e gjallë. Aty u qartësua se duhej të rrinte me Anton le Gras që ishte i sëmurë, por një ditë ajo do t'i takonte një bashkësi të përkushtuar shërbimit të të varfërve. Kjo qartësi e liri edhe besimin e saj nga të gjitha dyshimet që e trazonin. Ndërkimi i mrekullueshëm e bëri Luizën të kuptojë se së shpejti ajo do të njihte drejtuesin shpirtëror, në të cilin do të ketë mundësi të mbështetet me besim.

Kjo shndritje do të jetë gjithmonë Rrëshajë për Luizën dhe ajo do të ketë ndaj Shpirtit Shenjt gjithmonë një devocion të jashtëzakonshëm dhe me bazë të mirë teologjike.

Vuajtjet nuk do ta lironjë akoma dhe kryqi do të rëndojë edhe më shumë, kur më 21 dhjetor 1625, vdekja ia merr bashkëshortin, me të cilin për dym-



Motrat vinçenciane nga Kosova

bëdhjetë vite kishte jetuar një jetë bashkimi solid të dashurisë bashkëshortore dhe të fesë së krishterë. Ajo pohon *"Hyji më ka dhënë të kuptoj se vullneti i tij ishte që unë të shkoj tek Ai nëpërmjet Kryqit të cilin mirësia e tij desh, i*



që ta kem që nga vetë lindja ime, duke mos më lënë gati në asnjë moshë paraste vuajtjesb"

Vejëria i ofron mundësi për jetë shpirtërore, për të bërë ushtrim përshpirtërie. Në fillim të vitit 1625 vihet nën drejtimin shpirtëror të Vinçenc de Paul të cilin Shpirti Shenjt ia kishte zbuluar ditën e Rrëshajëve dy vite më parë kur ajo u qartësua nga të gjitha dyshimet dhe trazirat. Për 35 vite Vinçenc de Paul dhe Luiza

de Marillac punuan së bashku në Misionin, që Hyji ua kishte besuar. Leximi i një numri të madh letrash që kemi arritur t'i kemi (më shumë se 600) na bën të zbulojmë rrugën e mahnitshme dhe të mrekullueshme të miqësisë së tyre. Si në Vinçencin, po ashtu në Luizën, shenjtëria nuk ishte e lindur. Ajo gjen mbështetje në njerëzimin e tyre, marrëdhënia e tyre me Hyjin, me të varfrit, marrëdhënia reciproke e tyre, pak nga pak e transformoi gjithë genien e tyre, e përsosi dhe e zbkuroi. Luiza de Marillac nuk i ngatëroi asnjëherë dëgjuesin me pritje dhe pasivitet, ajo mori pjesë në të gjitha ndërmarrjet e bamirësisë së atit shpirtëror të saj si organizatore: qofshin Zonjat e Dashurisë së Krishterë, Bijat e Dashurisë së Krishterë, fëmijët e braktisur, galerianët apo pleqtë. Luiza ishte për Vinçencin ajo mbi të cilën mund të llogariste gjithmonë madje edhe pa e lajmëruar. E tillë ishte vegla që Provania hyjnore e kishte vënë në rrugën e Vinçencit dhe në vitin 1633 ishte çdo gjë gati për të themeluar Kongregatën e re me vajzat fshatare, të cilat do të marrin emrin nga populli Bijat e Dashurisë së Krishterë. Luiza bëri një punë shumë të rëndësishme në formimin e këtyre vajzave për t'i bërë ato të afta shpirtërisht për shërbimin që ato do t'ia bëjnë të varfërve të shumëllojshëm.

Pasi që Luiza i ka thënë gjithmonë "PO" dashurisë së Jezu Krishtit këtë "PO" e psherëtiu edhe me frymën e fundit të jetës së saj me 15 mars 1660. Familja Vinçenciane është e pranishme edhe në popullin tonë shqiptar e përfaqësuar nga Lazaristët (Kongregata Misionare), Bijat e Dashurisë së Krishterë dhe Rinia Mariane Vinçenciane. Vepromë në Leticë, Stubëll, Pejë, Gllogjan, Zllakuqan, Klinë, Prishtinë, Durrës, Shkodër, Grudë të Re, Rrëshen, Gramsh, Mollas për t'iu shërbyer të sëmurëve në spitale dhe për t'ua bërë të varfërve pa dallim feje, race, gjinie, moshë, të ditur se Zoti ynë Jezu Krishti u ngjall nga dashuria tepër e madhe që ka për ne.

Bashkimi, mirënjohja, përkujtimi, dashuria dhe gëzimi i të gjithë anëtarëve të Familjes Vinçenciane, anë e kënd botës u takuan në zemrën e Hyjit. Dhe në nder të këtyre dy shenjtërve të mëdhenj të Kishës lavdëruam Zotin me hapjen e vitit Jubilar të 350-vjetorit të lindjes së tyre për qiell.

Injektiv përjetim vazhdoi të zërë vend edhe tek anëtarët e familjes vinçenciane të trojeve hqiptare të Kosovës dhe Shqipërisë.


Fillimin e këtij Jubileu e kremtuam më 27 shtator 2009, me solemnitetin e Meshës së Shenjtë të kremtuar nga Monsinjor Cristoforo Palmieri dhe bashkëvëllezërit meshtarë vinçencianë dhe meshtarë të tjerë, të mbledhur në kishën e Grudës së Re të dioqezës së Shkodrës. Në sofrën Eukaristike morën pjesë shumë besimtarë laikë, Bijat e Dashurisë së Krishterë dhe Rinia Mariane Vinçenciane nga famulli të ndryshme të Kosovës dhe Shqipërisë. Gjatë meshës së Shenjtë falënderuam Hyjin për këtë dhuratë dhe i kërkuan hirin për të qëndruar besnik ndaj kësaj karizme.

Nxiti për t'i shërbyer dhe dashur të varfrit dhe të sëmurët, nuk mungoi në homelinë e Shkëlqesisë së Tij Cristoforo Palmieri duke thënë: *"Të lëvdojmë Hyjin për të varfrit që janë shenjë provanie për ne nga vet Ai. Të jemi vegla në duart e Tij në mes të të varfërve për të lehtësuar vuajtjet, për të rritur fenë dhe gjallëruar shpresën. Të njohim atë që na kanë mësuar dhe praktikojmë atë që kanë jetuar Shën Vinçenci dhe Shenjta Luiza."*

Pas tryezës Eukaristike u mblodhëm në një agape vëllazërore në Fshatin e Paqes duke bashkëndarë urimet me të pranishmit, ndër të cilët ishin edhe SH. Tij mons. Angelo Massafra si dhe shumë të varfër dhe të sëmurë të cilëve iu shërbejmë.

Falënderojmë Zotin për këtë Jubile kaq të madh dhe të vazhdojmë së kërkuari Hyjit zemër për të dashur dhe duar për të shërbyer atyre që kanë nevojë.





Intervistë me regjisorin dhe skenaristin kosovar Gjon Kolëndrekaj

Afrim i qytetërimeve përmes krijimtarisë kinematografike

Arsyet për të biseduar me Z. Kolëndrekaj ishin më se të mjaftueshme. Regjisorin kosovar nga Peja, më tepër se tridhjetë vjet, suksesshëm krijon e vepron në Itali. Krijimtaria e tij kinematografike me vlerat që i shquan, ka tejkaluar kufijtë e shtetit italian dhe ka marrë dimensione internacionale. Është një personazh i dalluar në fushën e regjisë dhe skenarit që ka prurë gjëra origjinale e të veçanta, çka tregon edhe dokufilmi dhe libri mbi jezuitin e famshëm Matteo Ricci, "Matteo Ricci, un gesuita nel regno del drago". Kjo u dëshmuar edhe në premierën e Romës – Vatikan, ku ishin të pranishëm figura eminente të Vatikanit, të shtetit dhe kulturës italiane dhe ato kineze, si: Kardinali Camillo Ruini, sekretari i Papës Mons. Georg Gänswein, Argjipeshkvi Claudio Maria Celli, kryetar i Këshillit Papnor për Komunikimet Sociale, Ambasadori i Republikës Popullore të Kinës pran shteti Italian në Romë, Sun Yuxi, P. Federico Lombardi S.J., drejtor i sallës së shtypit të Selisë së Shenjtë dhe Drejtor i Radio Vatikanit. Po i njëjti dokufilm u shfaq në muajin shtator në Festivalin internacional të Filmit në Venedik, dhe më 17 tetor në Festivalin internacional të Filmit në Romë.

Zotëri Gjon, para një audiotori të gjerë akademikësh, ambasadorësh, kardinalësh, politikanësh e gazetarësh profesionist italian, u shfaq më 18 qershor në Romë premiera e dokufilmit Tuaj "Matteo Ricci, un gesuita nel regno del drago" (Mateo Ricci, një jezuit në Mbretërinë e dragoit), një dokumentar i përmasave internacionale? Çfarë ju shtyri të bëni këtë dokumentar kaq të veçantë?

Gjon Kolëndrekaj: Profesionistisht ajo çfarë më intereson të realizoj, është ekskluziviteti i krijimtarisë audiovizive që regjisorët e skenografët tjerë nuk i kanë realizuar. Në mënyrë specifike do të doja t'i shkëpus disa shembuj:

Në vitin 1987 kam ideuar "Sacro Corano" në film të animuar, nën autorizimin e Al-Alzar nga Egjipti, njëri nga autoritetet më të larta të botës islamike dhe përkrahësin e dialogut ndërfaqetor të nisur nga Ati i Shenjtë Gjon Pali II. Këshilltari im i parë ishte dr. Haris Selajdić, dizajni ishte vepër e fituesit të oskarit, kroatit Vukotić dhe realizues ekzekutiv ishte Emilio Pascucci me origjinë serbe. Po këtë vit kam realizuar një videoclip me kamionet e futbollit nga e gjithë bota me titull "Alleluia". Ishte gjesti i parë mbarebotëror për të ndihmuar ata që vuajnë.

Me dokufilmin "Matteo Ricci, un gesuita nel regno del drago", doja të përkujtoja këtë misionar, që me fenë dhe me shkencën e tij ka

ngritur në nivelin e lartë njerëzimin dhe dialogun mes Perëndimit dhe Lindjes së Largët. Në Kinë Matteo Ricci konsiderohet si një dijetar, mjeshtër i madh i Perëndimit që bëri të lindte te kinezët vetëdija se ata nuk janë të vetmit, të izoluar, përkundrazi se janë të rrethuar nga një botë e tërë që duhet njohur.

Marrëdhëniet mes Kinës dhe Vatikanit – Selisë së Shenjtë, qëmoti nuk janë të dëshirueshme. Dokumentari Juaj bëri që një ambasador kinez të jetë për të parën herë i pranishëm në një sallë të Shtetit të Vatikanit dhe të japë një deklaratë thuajse të papritshme për opinionin. A mund të jetë figura shumëdimensionale e Matteo Riccit shtysë shpresëdhënëse në këtë drejtim? Dhe a mendoni se ngjarje kulturore si kjo mund të jenë shtysë e hapave konkret për dialog?

Gjon Kolëndrekaj: Figura e Matteo Riccit që del nga dokufilmi, paraqitet si shembull i ndërmjetëm e i drejtpërdrejtë me qëllim të sensibilizimit të njeriut për vetëdijesimin/njohjen e kulturave të ndryshme, dhe se, mes etnive, religjioneve dhe kulturave të ndryshme, është e mundur bashkëjetesa sinergjike/ndërvepruese mbi themele të përbashkëta të dialogut dhe respektit të ndërsjellë. Në dritën e dialogut që krijon çdo miqësi, ekspresioni artistik dhe mediatic i këtij dokufilmi ka bërë të mundshëm afrimin mes Kinës dhe Vatikanit



“ Me dokufilmin "Matteo Ricci, un gesuita nel regno del drago", doja të përkujtoja këtë misionar, që me fenë dhe shkencën e tij ka ngritur në nivelin e lartë njerëzimin dhe dialogun mes Perëndimit dhe Lindjes së Largët. Në Kinë Matteo Ricci konsiderohet si një dijetar, mjeshtër i madh i Perëndimit që bëri të lindte te kinezët vetëdija se ata nuk janë të vetmit, të izoluar, përkundrazi se janë të rrethuar nga një botë e tërë që duhet njohur. ”

“Atdheu im shumëçka ka mbjellë në ndjenjat e mia, në virtytin e mikpritjes dhe bashkëjetesës, dhe falë këtyre dhuntive që kombi im përbrendësisht i ka krijuar brenda qenies sime, kam mund të jem eksplorator i ndjenjave të të tjerëve, fytyrave dhe historive të tyre.”

e anasjelltas. Nën këtë prizëm të thikët të dialogut dhe të krenarisë së shëndoshë, mund të them se isha i vetmi perëndimor, aq më tepër katolik, që realizova këtë punë me aprovimin e Qeverisë Kineze. Përndryshe, nën patronatin e Qeverisë Italiane, “Matteo Ricci, un gesuita nel regno del drago” do të prezantohet në expo universale të Shangait në 2010 me qëllimin që ky projekt multimedial, libri+dokufilmi, të shndërrohet në simbol të kulturës, të komunikimit dhe të dialogut mes dy kombeve.

Matteo Ricci është jezuiti që arriti të fut në dialog dy kultura të mëdha, atë kineze dhe perëndimore, që para tij nuk kishte arritur askush. Ai gëzon edhe sot një reputacion jashtëzakonisht të madh tek populli kinez, si shkencëtar, misionar katolik - ungjillëzues. Ku qëndronte fuqia e këtij prifti e shkencëtari që të mbetet pishtar i inkulturimit dhe dialogut ndërkulturore dhe ndërfaqës?

Gjon Kolëndrekaj: Sekret i Atë Matteo Ricci, suksesi i misionit të tij, qëndron në aftësinë e tij për t'u lëshuar në dëgjim të thellë e krejt të vetëdijshëm në kulturën mijërvjeçare kineze, për t'i kuptuar traditat, zakonet e doket e tyre me respekt të kujdesshëm dhe pa përkufizime e paragjykimë çfarëdo qofshin. Jezuiti italian i ka bashkuar dy qytetërimet, që ishin aq larg si toka me qiell, e që nuk mund të komunikoheshin mes veti. Larg-

pamësia e tij dhe dashuria për të “shkuar matanë” kanë bërë të mundshme ndërtimin e një ure të vërtetë të dialogut ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes. Mbi të gjitha, Matteo Ricci mund të definohet si “Ambasadori i Evropës” për të gjitha kohërat.

Dokufilmi Juaj u vlerësua shumë lart nga Këshilli Papnor për Komunikimet Sociale, nga Shoqëria e Jezuitëve dhe nga Ambasadori Kinez pranë shtetit italian, çka ishte një shenjë për tu admiruar. Madje, këto ditë shtypi italian dhe botëror gjithandej ka vlerësuar dokumentarin tuaj si arritje profesionale dhe kulturore. Çfarë do të thonë gjitha këto për Ju si artist?

Gjon Kolëndrekaj: Jam vërtetë i nderuar për këtë vepër unike dhe të njohur në nivel internacional, i realizuar nën patronatin e Këshillit Papnor për Komunikimin Social, të Kurisë Gjenerale të Shoqërisë së Jezuitit, të Dioqezës Macerata dhe të Ministrisë të Punëve të Jashtme të Italisë. Për mua është gjithashtu një mirënjohje e profesionalizmit tim dhe atyre vlerave të larta që veprat e mia dhe krijimtaria produktive përherë i kanë shprehur. Shtypi nacional e internacional e ka mbështetur veprimtarinë krijuese timen duke u përqendruar me vëmendjen e shtuar tek ekskluziviteti dhe uniteti i veprës, parimisht të figura e Matteo Ricci, e mandej edhe tek domethënia kulturore dhe diplomatike. Këto elemente

pozitive të kredibilitetit në nivelin nacional dhe internacional më inkurajojnë për të vazhduar me projekte tjera në të ardhmen.

Ju jeni ideator dhe realizues i një vargu të dokumentarëve në RAI UNO që kanë pasur famë botërore. Për çfarë dokumentarësh bëhet fjalë?

Gjon Kolëndrekaj: Siç e thashë më parë, veprat e mia janë origjinale dhe kërkojnë shumë angazhim për t'u realizuar. Që në fëmijëri kam qenë i prirë për sfida dhe punë të vështira që kërkonin angazhim. Kam realizuar gjithnjë forma të reja televizive, transmise me liderë që kanë tërhequr një publik të madh, si p. sh. *mbi të mirat kulturore dhe ambientet nacionale dhe internacionale, mbi ushqimin dhe mbi teknologjitë e reja*. Në të gjitha transmiseve e mia kam tentuar të jem i dobishëm për sensibilizim dhe për dëshirat e çdo spektatori, siç janë “Linea Verde”, “Made in Italy”, “Opla il Circo”, “Happy Circus”, filmi “Passione di Cristo”, i interpretuar nga fëmijët dhe “Icône, gli occhi di Dio”. RAI, përveç kësaj, disa prej transmiseve të mia kinematografike, i ka shitur në gjithë botën: “Il Sacro Corano”, seria e “Viaggio nei luoghi del sacro”, personazhe të famshme në vendet e shenjta dhe shumë produksione tjera. E kam kaluar tri herë mbarë botën duke kërkuar të sjell në ekran të vogla e të mëdha, madhësinë dhe inteligjencën e qenies njerëzore në ballafaqim me njerëzinë e tij. Çmimet internacionale më kanë dekoruar për përkushtimin ndaj vlerave njerëzore që i shprehni në të gjitha veprat e mia.

Ju jeni nga Kosova, pikërisht nga Peja. Cilat janë raportet e Juaja mes kulturës dhe kinematografisë kosovare dhe shqiptare në përgjithësi?

Gjon Kolëndrekaj: Raportet ndërmjet Italisë dhe shtetit të ri Kosovës janë antike dhe të njëjta dhe të kamotshme. Këtë e dëshmojnë paraardhësit tanë dardanë të familjes ilire që gjen-den në matanë bregdetit italian të Detit Adriatik. Pra, gjithmonë ka qenë një raport vëllazëror e bashkëjetësor me kulturën dhe qytetërimin italian. Natyrisht, duke dhënë identitet më të madh asaj që janë rrënjët tona dhe kul-

tura jonë kosovare, shpresoj se në një të ardhme të afërt, me hyrjen e Kosovës në Bashkimin Evropian, do të ketë mundësi të zhvillohen e të përthellohen çështjet e përbashkëta në planin botëror e do të krijohet mundësia që edhe Kosova dhe kultura e saj të vihet në skenën ndërkombëtare. Qytetërimi dhe kultura jonë janë shembull dhe ndihmë për gjithë njerëzimin; një shembull që e trashëgojmë nga bashkatdhetarja jonë, e Lumja Nënë Tereza e Kalkutës, fituesja e çmimit Nobel për paqe.

Marrëdhëniet kulturore mes Italisë dhe Kosovës, do të duhej të rriteshin; nëse po, në cilën fushë, e si do të mund të realizoheshin ato?

Gjon Kolëndrekaj: Jam shumë krenar që jam kosovar, dhe prej se kam ardhur në Romë në vitin 1974, s'jam ndalur të flas për Kosovën, për qytetin tim Pejë, i shtrirë buzë Bjeshkëve të Nemuna, atje ku fëmijëria dhe adoleshencia ime e parë kanë kaluar si në një film bukolik e fantastik. Gjithmonë e mbaj në zemër atdheun tim e njëkohësisht ndjej një keqardhje/nostalgi për qytetet e Kosovës dhe fshatrat që tashmë e kanë humbur atë që ishte identiteti tyre peizazhist dhe arkitonik. Shpresoj se bukuritë natyrore të Kosovës dhe traditat e banorëve të saj do të ketë mund të tregohen një ditë në një vepër kinematografike. Atdheu im shumëçka ka mbjellë në ndjenjat

e mia, në virtytin e mikpritjes dhe bashkëjetesës, dhe falë këtyre dhuntive që kombi im përbrendësisht i ka krijuar në mua, kam mund të jem eksplorator i ndjenjave të të tjerëve, fytyrave dhe historive të tyre.

Cilat janë aspiratat e Juaja si regjisor dhe skenarist në të ardhmen?

Gjon Kolëndrekaj: Për të ardhmen e afërt kam një projekt për figurën tejet të rëndësishme, që popullin tonë e ka bërë të njohet në tërë botën; **Nëna Terezë**. Ideja është që t'i kushtohet një film fëmijërisë së saj, e për këtë gjë është e drejtë që atdheu i saj, Kosova dhe udhëheqësit e saj, t'ia kushtojnë kësaj figure hapësirën, kohën e mirënjohjen që e meriton. Po ashtu, është e drejtë që artistët kosovarë, si unë e intelektualët tjerë, historianë, religjiozë e njerëz të vullnetit të mirë, të përgatiten për t'i dhënë një rëndësi të drejtë, mirënjohje e rezonancë figurës së Nënë Terezës, rrënjëve të saja, atdheut të saj, sepse falë saj, kosovarët *qenë kapur prej syve të botës*. Do të jem në Kosovë për të realizuar këtë projekt të përmendur e mendoj ta përfundoj gjatë vitit 2010, në të cilin vit koincidon 100-vjetori i lindjes të së Lumes Kosovare.

Romë, më 18 tetor 2009.

Intervistoi për “Dritën”:
Don Fatmir KOLIQI

JETËSHKRIMI

Gjon Kolëndrekaj ka lindur në Pejë, ka studiuar pranë “Centro Sperimentale di Cinematografia” të Romës. Nxënë i Joris Evens, ka bashkëpunuar me Valerio Zurlini, Miklos Jancso dhe Frank Capra. Është autor i shumë dokumentarëve të suksesshëm në Rai Uno, programeve televizive dhe filmave. Është shpërblyer me shumë çmime kinematografike në shumë pjesë të botës me mirënjohje për cilësitë e tij artistike dhe angazhimin e tij kulturor. Jeton në Romë me familjen e tij dhe vazhdon të krijoj vepra artistike me sukses.

REAGIM

Më 20 qershor 2008 në një intervistë me gazetarin Bekim Salihu për gazetën “KOHA DITORE”, janë gjetur disa pasaktësi që nuk i kam thënë, e për atë dua të jap disa shpjegime:

Asnjëherë nuk kam cituar Giordano Brunon e gjithat që kanë të bëjnë me inkuizicionin, pikërisht sepse me Matteo Riccin hapet një kapitull krejt i ndryshëm i Kishës, në hapësirë, në kohë e me çështje krejtësisht të ndryshme aq të papajtueshme me historinë e inkuizicionit. Dy gjëra këto shumë të ndryshme.

Atë Matteo Ricci asnjëherë nuk e ka mohuar rëndësinë e fesë, përkundrazi falë fesë së tij dhe ngulmit të tij ka ditur të bartë Fjalën e Hyjit në një tokë ku ishte në fuqi një kulturë krejtësisht tjetër dhe një perceptim i ndryshim i të shenjtës. Atë Matteo Ricci e ka dëshmuar fenë duke u nisur mbi të gjitha nga hedhja e premisave/supozimeve të nevojshme për një dialog të sinqertë e të përthelluar, duke e shfrytëzuar atë për ndërmjetësim kulturor e shkencor, pa imponuar asgjë!

Atë Matteo Ricci ka paraprirë hapjen misionare të Kishës në takim me bota të largëta, i propozuar nga Koncili II i Vatikanit 400 vjet më vonë. Ai ka bartë një respekt për kulturën kineze, por njëkohësisht nuk e ka mohuar prejardhjen e tij.



Nëna Tereze dhe shqiptarët

■ SHKRUAN:
Ndue UKAJ

Njeriu si qenie shoqërore, është i lidhur dhe bashkëjeton me ngjarje, fenomene e personazh të rëndësishëm. Njeriu, si qenie e si identitet, është i lidhur me figura kombëtare, me të cilat identifikohet e nga të cilat ushqehet në rrugët e tij. Kështu është puna edhe me kombet, të cilat gjallojnë nga këso shtresimesh. Për shqiptarët, Nëna Tereze është objekt i krenarisë kombëtare, një shembull i motivueshëm që s'e ka bota, një model që ka shenjuar kohë dhe ka hyrë përjetësisht në panteonin e vlerave bipolare, Tokë e Qiell. Prandaj është fat i madh t'i takosh kombit të një njeriu që ka shenjuar kohën, shekullin, ka trandë në themel teori e doktrina, se bota mund të drejtohet vetëm me armë, ushtri, pushtet, para e fuqi. Nëna Tereze ka trand themelet e një bote të egërsuar, egoiste, në të cilën dashuria është një nocion abstrakt dhe ka dëshmuar të kundërtën, se bota mund të drejtohet me dashuri, se dashuria është fuqia më e madhe që transformon botën. Dhe pikërisht këtë nocion abstrakt, Nëna Tereze e ka konkretizuar më mirë se çdo kush në historinë botërore, duke dëshmuar me shumësi veprash të jashtëzakonshme, e të pakapshme për mendjen njerëzore, se jeta është dashuri, të cilën duhet ta përjetosh. Nëna Tereze jetën e përjetoi se dashuri, e atë ja dhuroi botës me dashuri, duke e bërë fuqinë e saj të rrezatoj kudo në botë.

Filozofia dhe qytetërimi i dashurisë

Motoja e së madhes Nënës Terezë se: "Vetëm dashuria mund ta shpëtoj botën", jo vetëm që grish për të ndihmuar të vuajturit që gjenden në mjerimin e skajshëm, pa fajin e tyre, por është shndërruar në një formulë magjike, që troket në ndërgjegjen njerëzore, për një përbashkim drejt vlerave sublime, të tejkohshme dhe universale.

Nëna Tereze, duke i tejkaluar fuqishëm përmasat kombëtare, fetare, është ngritur në pedestalin më të lartë të vlerave botërore. Jo vetëm kaq, ajo është shenjëzimi i njeriut model, që me dashuri e sakrificë tundi gjitha filozofitë, doktrinat, empiritë e jetës, duke krijuar një filozofi të re, një model të ri, një civilizim të ri, qytetërimin e dashurisë, siç shkruan biografi më i madh i Nënës Terezë, Don Lush Gjergji.

Nëna Tereze tejkaloi gjitha mundësitë njerëzore, duke hyrë padekësisht në panteonin e

vlerave me sublime që ka dhënë bota në dymijëvjeçarin tonë. Ajo mbetet një vlerë sublime për gjithë njerëzimin, duke flakur dallimet e gjithfarshme dhe duke ndërtuar filozofinë e saj, qytetërimin e saj, që është thellësisht qytetërim i dashurisë dhe duke tejkaluar fuqishëm përkatësinë religjioze, nacionale, doktrinare, në funksion të së mirës së përbashkët që për intencë kishte Njeriun. Dashuria e saj, ndërtoj një kështjellë të pamposhtur, ngase ajo krijoi filozofinë më të veçantë, nga e cila vazhdon të magjepsset njerëzimi, përtej dallimeve ideologjike, kombëtare e fetare. E madhja Nëna Tereze thoshte: "Në vend që të ankohesh për errësirën, më mirë ndiz një qiri". Dhe ajo e bëri këtë përgjatë gjithë jetës së saj, ndezi nga një qiri çdo kund në botë, ujiti thatësitë e shumta me dashuri, zbuti shpirtrat njerëzor në çdo cep të botës me urtësinë Hyjnore. Ishte një murgeshë e madhe dhe një shqiptare e madhe.

Prandaj, sot kur ajo është përjetësuar në Lumturi, Ajo nuk ka nevojë për nderimin tonë, përkundrazi ne kemi aq shumë nevojë për Atë, për pulsën e saj dhe filozofinë e saj, për madhësinë e saj, që të inspirojë jetën tonë në rrugët e formësimit e konsolidimit. Pra, të bëhet pjesë e pandashme e edukimit tonë kombëtar, mbi të gjitha e konsolidimit nacional.

Nëna Tereze nuk ishte vetëm një edukatore, një murgeshë e përkushtuar pas të varfërve, një solidarë e jashtëzakonshme, një misionare e Zotit, por, ajo ishte edhe një poetë, një mendimtare, e cila i la trashëgimi botës për-siatje, vargje/urate që ngërthejnë një filozofi të bujshme të urtisë dhe magjisë së fjalës. Poezitë e saj si: Jeta, S'ka rëndësi, Koha, etj. janë një shembëllim i fuqishëm i filozofisë së jetës, ku sintetizohen gjitha tiparet dhe emocionet e njeriut. Këto janë vargje antologjike të përdorshme çdoherë e në çdo kohë. Dhe ku, triumfalisht ngadhënjën filozofia e saj që tejkalon çdo të keqe, sepse ajo e ka antipod të mirën, pas së cilës duhet të priret njeriu. Çdo fjalë e varg i Nënës Terezë grish fuqishëm dhe bindshëm nga e mira, nga sublimja, nga vlerat universale, dhe sfidon kështu sfidon antipodet e tyre.

Nëna Tereze dhe identitet modern shqiptar

Tendencat e shumta se Nëna Tereze nuk duhet të përdoret në diskursin kombëtar, janë të paqëndrueshme dhe krenarësisht qëllimkëqija. Përkundër këtyre tendencave që të eliminohet personaliteti i saj nga identiteti



“Ne mund të mburremi me të, sepse ajo ka qenë, është dhe do të jetë pjesë e pashmangshme e diskursit kombëtar, nga se me personalitetin e saj të gjithanshëm, mbinatyror dhe shumëdimensional, ka influencuar, po influencon dhe do të influencojë rrjedhat shqiptare, kulturën shqiptare, letërsinë shqipe, pikturën, muzikën, skulpturën dhe politikën në Kosovë.”

shqiptar dhe të kundrohet vetëm si person fetar, ajo vazhdon të jetë referencë e shumicës absolute shqiptare, duke u bërë pikë referimi, sepse kështu, pa asnjë ekzagjerim, shqiptari i bën nderin më të madh vetës, të mirës së tij. Ne mund të mburremi se tij, sepse ajo ka qenë, është dhe do të jetë pjesë e pashmangshme e diskursit kombëtar, nga se me personalitetin e saj të gjithanshëm, mbinatyror dhe shumëdimensional, ka influencuar, po influencon dhe do të influencojë rrjedhat shqiptare, kulturën shqiptare, letërsinë shqipe, pikturën, muzikën, skulpturën dhe politikën në Kosovë. Në këtë rast, duhet të përmendim sidomos filozofinë paqësore të Ibrahim Rugovës, e cila në esencë ishte e frymëzuar prej madhësisht së Nënës Terezë. Për presidentin dhe liderin e shqiptarëve të Kosovës, Dr. Rugovën ajo ishte model i lëvizjes paqësore prej së cilës u frymëzua. Dhe portretin e së cilës e mbajti sa që gjallë kudo ai punonte e vepronte. Madje, këtë lëvizje dom Lush Gjergji, biografi më i madh i Nanës Terezë e quan, me plotë logjikë, lëvizje tereziane. Ndërsa përmasat personalitetit të saj janë shtrirë

edhe në rrafshet praktike të jetës shqiptare. Sheshet kryesore në qendrat shqiptare mbajnë emrin e saj, kudo janë ngritur shtatore, rrugë, spitale aeroporte që mbajnë dinjitetshëm emrin e saj. Pra, Nëna Tereze është një personalitet i rëndësishëm, në mos më i rëndësishmi i jetës shqiptare.

Nuk është kult e as mit emri dhe vepra e saj për shqiptarët. Përkatësia e saj shqiptare, tanimë përbën një dimension të theksuar dhe evident në çdo aspekt të kombit shqiptar, duke ngritur dijen dhe vetëdijen për vlerat sublime, universale të saj, të cilat po përjetojnë e pranojnë nga gjithë shqiptarët. Personaliteti i Nënës Terezë që afro dy dekada është paradigma udhërrëfyese për shqiptarët, kudo ku flitet dhe ku shkruhet shqip, në hapësirat shqiptare, por edhe në ato të shpërndara ane e kënd botës. Ndaj, kështu është bërë hallkë shumë e rëndësishme e identitetit shqiptar, duke influencuar në përmasa të mëdha, funksionale kulturën shqiptare në tërësi.

Nëna Tereze duke qenë shqiptare, natyrisht është pjesë e identitetit shqiptar, frymëzon zemrat dhe mendjet shqiptare, ndikon drejtpërdrejt në zhvil-

limet dhe kahet e shoqërisë shqiptare dhe si e tillë është pjesë e pashmangshme e diskursit kombëtar, së këndejeje edhe e identitetit shqiptar. Tendencat e ndryshme, çfarëdo qofshin ato, për ta përjashtuar atë nga pjesa e identitetit shqiptar dhe për ta lënë brenda përkatësisë fetare, tashmë i përkasin së kaluarës, kur shqiptarët vërtiteshin mes dilemash të ndryshme dhe kur për shqiptarët flisnin ata që dirigjoheshin nga interesa të gjithfarshme. Ndërsa tash, kur këto dilema të mëdha janë qartësuar dhe orientimi perëndimor i shqiptarëve është vulltosur, nuk ka asesi të na mohohet e drejta për ta pasur Nanë Terezën, pjesë të rëndësishme të identitetit shqiptar, ashtu sikurse nuk mundet mendja racionale t'i u mohoj popujve tjerë që figurat e shumta universale t'i kenë pjesë të identitetit kombëtar.

Figura dhe emri i Nënës Terezë na bashkon përherë në rrugëtimet tona të ardhme si komb. Prandaj, në këtë përvektor të Lumturimit të saj, tok të bashkuar duhet të funksionalizojmë mësimin e saj në çdo pore të jetës, për të dëshmuar se ajo për ne përbën një rëndësi sublimë, të posaçme.

Botime me interes

Familja Albani, katër shekuj shkëlqim historik

(Prof.Dr. iur. Eqrem Zenelaj: *GJENEALOGJIA E FAMILJES SHQIPTARE ALBANI NGA URBINO DHE BERGAMO E ITALISË – PAPËS CLEMENTI XI ALBANI (PONTIFEX. MAXIMUS)*, Shëpia botuese “Faik Konica”, Prishtinë 2009

■ SHKRUAN:
Prend BUZHALA

Dr. Prof. Eqrem Zenelaj është intelektual shqiptar nga Theranda, i cili jeton dhe punon në Vjenë të Austrisë që 13 vjet. Në Prishtinë studioi e diplomoi në dy fakultete: Fakultetin Filozofik – profesor për filozofi-sociologji dhe Fakultetin Juridik –magjistër i shkencave juridike, drejtimi administrativ juridik. Kreu studimet e doktoratës në Universitetin e Vjenës, doktorori në Të Drejtën Ndërkombëtare dhe ka bërë edhe disa specializime, si në Francë – E Drejta Evropiane me thirrjen shkencore – Dr. Iur. Vijoi studimet dyvjeçare në Universitetin Passau të Gjermanisë, është në përfundim të një specializimi për të Drejtën Gjermane. Një vit ka punuar jurist praktikant në Gjykatën Supreme të Austrisë në Vjenë. Shkuesit gjatë viteve '70 e '80 e mbajnë mend si solist të njohur të RTP-së. Tani është edhe bashkëpunëtor i jashtëm i Institut Albanologjik të Prishtinës, anëtar e bashkëpunëtor i Institutit për Evropën e Mesme (IDM-Institut) me seli në Vjenë, ku edhe jeton me familje. Punoi edhe në disa universitete private, si Fama, e në Universitetin e Prishtinës.

Papa Albani, figurë elitare evropiane e shqiptare

Që 13 vite ai merret edhe me hulumtime të vjetra arkivore, ndër më të njohurat e më të çmuarat në Evropë. Gjatë hulumtimeve të tij të deritashme, ai ka hasur në dokumente interesante, të cilat dëshmojnë për historinë tonë kombëtare. Për këto dokumente dihet shumë pak ndër ne dhe janë pak të njohura. Ndër dokumente të shumta për figura, familje e personalitete të mëdha kombëtare, sikundër janë Papa Klementi XI (1700-1721), Papa Piu VI (1775-1799), si dhe figura të tjera që lidhen gjërisht me familjen Albani. Prandaj, kohëve të fundit u botua libri i tij që ka objekt studimi Papa Klementin XI dhe gjenealogjinë e familjes Albani. Është me interes të jashtëzakonshëm edhe historia papnore, pikërisht për t'i ndriçuar raportet që kanë pasur ndër mijëvjeçarë shqiptarët me Evropën, përkatësisht me Romën dhe me kontributin që kanë dhënë shqiptarët. Porse libri i Zenelajt shkon edhe më tutje, duke na e tërhequr vëmendjen të një paradoks i kohës sonë: sa shumë kanë shkruar të huajt për figura të shquara shqiptare që kanë bërë

emër në histori, dhe sa pak dimë ne për ta! Sa e sa herë vetë e kemi shtruar pyetjen nëpër vorbullat më të reja të historisë: kush kemi qenë, kush jemi dhe kah po shkojmë? Së këndejmi, kjo vepër na bën me dije njohjen e dokumentuar të të kaluarës sonë në shumë fusha dhe në raportet e shqiptarëve me qytetërimin evropian, pjesë e të cilit jemi. Gjithnjë me pasionin për hulumtime, ai vë në pah edhe qarqet e caktuara të politikave të huaja ditore evropiane e ballkanike që përpigjen edhe sot për t'i përvetësuar këto personalitete dhe vlerat tona kombëtare; për t'i shtrembëruar e falsifikuar faktet apo për t'i lënë ato në harrës. Nxjerrja në dritë e këtyre dokumenteve për Familjen Albani, dëshmon se kjo familje i ka dhënë Urbinos, Beggamos, Venedikut dhe Romës senatorë, diplomatë, piktorë, poetë, bibliotekistë, juristë dhe ushtarakë, ndërsa krishterimit dhe Selisë së Shenjtë i dhuroi gjashtë kardinalë të njohur dhe Papa Albanin. Figura e këtij pape shqiptar i kalon caqet e një personaliteti vetëm kishtar; Zenelaj na dëshmon se ai ishte dhe mbetet personalitet i njohur në histori, “me famë aq të madhe për kohën kur jetoi, një diplomat i rrallë dhe mendjempërtë, një papë dinjitoz, intelektual i lartë, largpamës dhe parimor në qëndrime e veprime, si dhe atdhetar i palodhur dhe i devotshëm i popullit shqiptar.”

Porse autori vijëzon edhe pajisjen e këtij pape me një kulturë të gjerë shkencore, juridike, fetare dhe njëkohësisht të edukuar nga vetë familja Albani, me ndjenja të flakta atdheadashurie. Eqrem Zenelaj në vëllimin e tij monumental, në dritën e dokumenteve të papublikuara arkivore, me të dhëna interesante, dëshmon “për shkëlqimin historik që kishte pasur për një kohë të gjatë familja Albani”. Papa Albani (Gjon Françesko Albani), erdhi në krye të Kishës Katolike të Romës në rrethana të ndërlikueshëm evropiane, në kohën e luftërave e konfliktëve ushtarakë. Por edhe në këso rrethanash, përkushtimi i Papa Albanit për çështjen kombëtare arbërore të kohës nuk reshti asnjëherë: me investime materialisht e shpirtërisht në ruajtjen e gjuhës shqipe e të fesë së Arbënisë, për të mos lejuar asimilimin fetar e kombëtar të shqiptarëve nga pushtuesi turk. Fryt i këtij angazhimi të jashtëzakonshëm, është ai tubimit të krerëve shqiptarë në Arbëni, në Kuvendin e Arbënit, me anë të Ipeshkvit të Tivarit – Vinçenc



Zmajević. Ai vetë u përkujdes t'i botonte materialet e Kuvendit të Arbënit, më 1706, që janë përfshi të plota e të fotokopjuara, edhe në këtë vëllim. I madh është kontributi i këtij pape edhe në botimin e Gramatikës së parë të gjuhës shqipe nga Atë Françesko Maria da Lecce (1716), si dhe në mbledhjen e materialeve historike të vjetra kishtarë, në Tivar, Raguzë e në vise tjera ilire. Zenelaj thekson: “Nga vetë Papa Albani u dha iniciativa dhe u mbështet projekti i hulumtimeve dhe i botimit të enciklopedisë Illyricum Sacrum (Iliria e Shenjtë)”, e cila në nëntë vëllime, u përgatit për 150 vjet dhe e cila tashmë është botuar edhe në Kosovë.

Albanët: papë, kardinalë, diplomatë, njerëz të artit, dijes...

Projekti hulumtues e shkencor i Eqrem Zenelajt, siç e thotë autori, ka më shumë karakter informimi, afirmimi, dokumentimi dhe karakter arkivor që iu dedikohet lexuesve shqiptarë dhe të huaj. Në pjesën e parë të librit autori merret me domethënien e fjalës “Kelmendi – Clementi” në literaturën e huaj, i cili ndër ne është mbimërm, emër fisi, toponim etj, por në Evropë ai haset që nga lindja e krishterimit tek emri i disa papëve dhe të emri i fortesës Klementiana (sipas Prokopit). Të pjesa e dytë merret me gjenealogjinë e familjes Albani, duke dëshmuar se i pari i familjes Albani ka qenë shqiptari Mikel Lazii, me dëshminë se kjo familje kishte shkuar nga Shqipëria, me djemtë: Gjergjin, Filipin dhe Andrian, diku kah viti 1464. Ata qenë luftëtarë trimë e kapëdanë të ushtrisë së Skënderbeut, shkuan atje me detyrë të caktuara, por shkuan edhe si refugjatë gjatë invadimit osman. Gjergji dhe Filipi caktohen menjëherë në detyrë të larta me përgjegjësi ushtarake dhe politike nga duka i

Urbinos. Mandej ndahen dy degë të familjes, në Urbino e Bergamo. Më nuk u kthyen në atdheun e tyre. Autori përmend edhe emra të tjerë të gjenealogjisë së këtyre familjeve, kurse ndër figura të njohura përmend në veçanti piktorin e famshëm Françesko Albani, shkrimtarin Engjëll Albani, kapitenin e gardës së papëve Malatesta Albani. Vëllai i papa Albanit, Oraci Albani, ishte senator, kishte tre fëmijë në poste të larta (Anibali II dhe Carolus III). Rrjedhën gjenealogjike Zenelaj e përcjell deri te shekulli XIX, kur më nuk duken Albanët. Të dhënat janë marrë edhe nga një libër që autori e gjet në Arkivin e Bibliotekës Kombëtare të Austrisë, në original, i botuar në latinisht, i shkruar nga një sekretar personal i papës, apo nga një nëpunës i oborrit papnor, diku kah viti 1721, në kohën e papa Albanit. Të rrënjët e “Pemës gjenealogjike” është paraqitur një stemë me një kurorë mbretërore të Principatës Shqiptare, nga e cila vjen familja Albani. Autori hedh mendimin se kjo është stemë e princit shqiptar, Mbretërisë së Skënderbeut. Kjo stemë figuron tek të gjithë Albanët në katër shekuj. Autori jep edhe të dhëna biografike për të gjitha figurat e njohura të kësaj familjeje. Jep figurën prej shkencëtar, intelektual, ushtaraku dhe njeriu të besimit të kardinal Gjon Hieronim Albanit (1504-1591), me karrierë të bujshme ushtarake e diplomatike, ishte disa herë kandidat për papë, doktor i shkencave juridike, këshilltar personal i papa Gregorit XIII. Tre djemtë e tij ishin në zë, në radhët e fisnikërisë së lartë të Romës. Diplomati i njohur i kohës ishte Oracio I Albani (1576-1653), senator i Romës, kurse djali i tij Anibale I Albani (1605-1650) ishte drejtor i Bibliotekës së Vatikanit. Nga Oracio I dhe gruaja e tij Olimpia ka lindur babai i Papa Clementit XI, Carlo II Albani, i cili ishte pedagog i njohur që fitoi titullin “Kamerling” (Mjeshër) në Dhomën e Kardinalit të njohur Carlo Barberini. Anibali i Parë ishte Mbikëqyrës dhe Prefekt i Bibliotekës së Vatikanit. Vëllai i i vogël i Papa Albanit, Orazio II Albani (1663-1712), djemtë e të cilit u ngritën në hierarki kishtarë, si Carolus III Albani (1687-1724), ky vdiq i ri dhe ishte dukë i Sorianos, i zgjedhur Princ i Al Saglios. Orazio III Albani, vdiq në vitin 1803, ishte personalitet me ndikim, Protëktor i Oborrit Papnor për Poloninë dhe Republikën e Raguzës. Djali i tij, kardinali Andrea Zef Albani, ishte sekretar

i shtetit të Vatikanit. Kardinali Anibali III Albani (1682-1751), që jetoi në kohën kur xhaxhai i tij u zgjodh papë, e i cili në moshën 18-vjeçare pranohet në “Qarkun e Selisë së Apostujve”, vijoi me karrierë deri te titulli i kardinalit, ishte “Kamerleg i Kishës së Shenjtë”, ndërsa u emërua edhe “Kancelar i Dijës”, “President i Dhomës Apostolike Kanunore” të Shën Pjetrit, e, meqë kishte aftësi politike e diplomatike, u emërua “Nunc i Jashtëzakonshëm Papnor” në Vjenë të Austrisë. Kishte formuar “Koncilin e Kardinalëve” me 19 kardinalë, ishte propozuar për t'u zgjedhur edhe papë. Ishte dora e djathtë e papa Albanit. Përmenden rreth 15 tituj veprash që i la të shkruara dokumentare, kishtarë, epistolare, juridike, biografike (biografi për Papa Albanin) etj. Kardinali Aleksandër Albani (1692-1779), djali më i ri i Oracios III, me prijje për kulturë, art e shkencë klasike, u mor me veprimtari politike, ushtarake, diplomatike, fetare, arkeologjike e shkencore, njihte greqishten klasike e latinishten, krijoi një koleksion të pasur me veptra të klasikëve greko-romakë. Ishte anëtar ndëri dhe rektor i studimeve të Akademisë në Romë, nunc në Austri, prelat i Dhomës së Apostujve, president i Akademisë së Papëve etj. Kardinali Aleksandër Albani, koleksionist i antikitetit, me rreth 300 veptra. Zenelaj jep edhe një histori e përshkrim të “Vila Albani”, e njohur për stilin dhe artin e ndërtimit. Kardinali Gjoni i Riu Françesko Albani (1720-1803), kishte karrierë të pasur kishtarë, mik i “çështjes së Polonisë”. Kardinali Gjuzeve Andrea Albani (1750-1834), pati karrierë të bujshme fetare e diplomatike. Ishte bibliotekist i Bibliotekës së Kishës së Shenjtë të Romës. Në pjesën e tretë, Eqrem Zenelaj jep një biografi të shkurtër të Papa Clementit XI – Gjon Françisko Albani (1649-1721), kurse në pjesën e katërt flitet për Kuvendin e Arbënit e rëndësinë e tij të madhe historike, fetare, gjuhësore, kulturore e kombëtare. “Koncili...” është shkruar në gegërisht, në gjuhën që e fliste vetë Papa Albani. Dëshmojete se Familja Albani në Itali kishte shkuar nga Veriu i Shqipërisë. Libri është i pajisur me fotokopje të shumta dokumentesh arkivore, me portrete nga kjo familje, jepet literatura e gjerë në gjuhën gjermane, latine etj, si dhe shtojcat prej rreth 150 faqesh e Kuvendit të Arbënit e ajo e Gjenealogjinë e Familjes Albani.

“Ti je nderi i Jerusalemit!”

“Ti je nderi i Jerusalemit! ti je lavdia e madhe e Izraelit! ti je mburoja e popullit tonë!” (jt 15, 9).

■ SHKRUAN:
Don Lush GJERGJI

Juditën e paraqet Bibla si grua vejë, tejet guximtare dhe vendimtare, e cila e mbyti Holofernin, armikun e përbetuar të popullit të Zotit. Ideja dhe porosia bazë e kësaj historie është kjo: shpëtimi i Izraelit vjen prej Hyjit dhe besnikërisë ndaj ligjeve të tij.

Në këtë tregim të bukur gjejmë përshkrimin e tri periudhave dhe ngjarjeve të ndryshme:

1. Pjesa e parë e paraqet Holofernin e tmerrshëm dhe rrezikimin e vazhdueshëm për popullin e Izraelit, uratën e popullit për shpëtim dhe besimin e madh të tyre në Hyjin /krh. Jd 1-6/.
2. Pjesa qendrore e paraqet figurën kryesore, protagonisten Juditën, vejë tejet e pasur dhe shumë e bukur, mbi të gjitha e mirë dhe besnike ndaj Zotit. Ajo kishte dëgjuar për hallet e popullit të saj, si dhe për planin e Oziisë për t'u dorëzuar Asirianëve /krh. Jd 8-13/.
3. Përfundimi është vërtet madhështor, Judita ia preu kryet Holofernit dhe kështu e shpëtoi popullin e saj /krh. Jd 14-16/.

Porosia bazë: Zoti është me të vegjlit, të shtypurit, të rrezikuarit, ata që nuk kanë kurrfarë ndihme tjetër përpos Zotit. Judita e paraqet popullin besnik të Zotit, i cili është i kërcënuar nga popujt tjerë dhe nga besëtytnitë e tyre. Nabukodonozori është armiku i Zotit dhe i popullit të tij, ndërsa Holoferni është mishërimi i krenarisë dhe epsheve njerëzore.

Lufta mes Zotit dhe Djallit, të mirës dhe të keqes, përfundon me ngadhënjimin e të mirës, ndërsa mjete për ta pasur Zotin në anën tonë është urata dhe pendesa, drejtësia dhe besnikëria ndaj Ligjit të tij.

në anën tonë është urata dhe pendesa, drejtësia dhe besnikëria ndaj Ligjit të tij.

Judita gjatë shekujve është identifikuar me Virgjërën Mari, ndërsa Holoferni me Djallin e mallkuar. Ajo nuk mbështetet në vetvete, as në fuqinë e popullit të saj, as në bukuri, në pasuri, në shkathtësi, por vetëm në Zotin.

*“Zot Emrin e ke!
Zbduke fuqinë e tyre,
Hyji i amshueshëm
Me fuqinë tënde
Shpartalloje ushtrinë e tyre...”*
/Jd 9, 8/.

Përse Judita rrezikon çdo gjë, jetën? Së pari për Zotin, pastaj edhe për Popullin e Zotit.

Ja shpjegimi i saj:
*“Bëj ta dijë çdo popull e fis
se ti je Hyji i gjithëpushtetsbëm
e i fuqishëm,
e se populli i Izraelit
përveç teje tjetër mbrojtës nuk ka!”* /Jd 9, 14/.

Para se t'ia prente kokën Holofernit ajo lutej kështu:

“Hyji i Izraelit, më jep fuqi në këtë ditë, o Zot, Hyji i Izraelit!” /Jd 13, 7/.

Edhe interpretimi i vrasjes së tij është një falënderim ndaj Zotit:

“Qe, koka e Olofernit, kryekomandantit të forcave të armatosura të asirianëve dhe, ja, mbulesa nën të cilën pushonte i debur. Zoti e goditi me dorën e një gruaje!” /Jd 13, 15/.

Një përshkrim i ngjashëm është edhe Estera, e cila po ashtu rrezikonte jetën e saj për ta shpëtuar popullin e Izraelit nga urdhëresat e Amanit, i cili dëshironte ta asgjësonte fenë e këtij populli.

Estera është bonjake, e rritur pa prindër, por e edukuar mirë në fenë e të parëve nga ana e Mardokut.

Shi Mardoku, edukatori dhe kujdestari i saj, ia përkujton preardhjen dhe detyrimet fetare:

“Lutju Zotit e fol me mbretin për ne e na shpëto nga vdekja,

“Nën mbrojtjen tënde po ngasim, o shenja Nëna e Tenzot, mos na i përbuz lutjet ndër nevojat toni, por, o Virgjër e lume dhe e bekuar, na shpëto përherë prej të gjitha rreziqeve, Zoja jonë dhe ndërmjetëse e jona. Amen.”



sepse Amanit, i dyti njeri në shtet pas mbretit, ka kërkuar shfarosjen tonë” /Es 4, 8a/.

Pas lutjes dhe agjërimit, Ester paraqitet para mbretit Asuerit, duke rrezikuar jetën e saj. Pas takimit dhe bisedimit me mbretin, e bindi që ta ndërronte vendimin e Amanit për shfarosjen e Hebrenjve.

Zoti e liron popullin e vet

gjithnjë nga robëritë e huaja nëpërmjet fytyrave si Judita, Debora, Estera, duke dëshmuar kështu fuqinë e tij nëpërmjet dobësisë njerëzore.

Estera e qetësoi sundimtarin persian Asuerin, Virgjëra Mari ndërmjetëson tek Zoti për ta larguar hidhërimin e shkaktuar nga mëkatet, dhe për të ngadhënjyer falja dhe dashuria.

Qysh në shekulli e dytë Shën Irineu i pari e përdori shprehjen për Marinë *“avokatja jonë”* për ta treguar rolin e saj ndërmjetëse dhe amnor për ne.

Urata Sub tuum presidium / Nën mbrojtjen tënde/, që është shkruar diku në Egjipt në shekullin e III-të dhe është përhapur pothuaj në mbarë botën, bindshëm dëshmon këtë:

“Nën mbrojtjen tënde po ngasim, o shenja Nëna e Tenzot, mos na i përbuz lutjet ndër nevojat toni, por, o Virgjër e lume dhe e bekuar,

na shpëto përherë prej të gjitha rreziqeve, Zoja jonë dhe ndërmjetëse e jona. Amen.”

Patriku i Antiokisë Severi /vdiq në vitin 538 pas Krishtit/ ndër të tjera lutej kështu:

“T’i drejtohem asaj që është Hyjlindëse dhe t’i lutem që të ndërmjetësojë për ne, ajo të cilën e nderojmë të gjithë shenjtërit”.

Gregori, ipeshkëv i Tours-it /vdiq në vitin 594 pas Krishtit/ i pari me shkrim i mbledhi mrekullitë e shumta me ndërmjetësinë e Zonjës Mari

Izidori nga Sevilja ishte një ndër të përshpirtshmit më të njohur të ndërmjetësisë së Marisë /vdiq në vitin 636 pas Krishtit/, duke i kënduar asaj këngë dhe himne të mrekullueshme.

Edhe patriku i Kostantinopojës Gjermani /vdiq në vitin 733 pas dorëheqjes së dhunshme nga selia apostolike/, na ka lënë në trashëgimi një seri të preteve mariane, ku hetohet përgatitja e tij teologjike dhe biblike, mbi të gjitha dashuria e tij bijësore për Nenën Mari.

Gjermani Marinë e ka cilësuar si *“ndërmjetëse për mëkatarë dhe shkalla e cila ka mundësi për t’i lartësuar njerëzit në qiell”*.

Në këto dy figura biblike, Judita dhe Estera, mrekullisht paralajmërohet dhe përgatitet Virgjëra Mari, ajo e cila me Birin e Zotit Jezu Krishtin, përfundimisht do të ngadhënjë mbi Djallin, mëkatin dhe vdekjen dhe do t’ia mundësojë mbarë njerëzimit shëlbimin e amshuar.

Shqyrtim për ne:

Sa ne e kërkojmë, njohim, pranojmë dhe plotësojmë vullnetin e Zotit në jetën tonë, veçmas në çastet e vështirësive, duke u mbështetur në ndihmën e Zotit dhe në ndërmjetësinë e Virgjërës Mari?

Sa edhe ne jemi bashkëpunëtorët e Zotit dhe të Marisë për shëlbimin tonë dhe të njerëzimit?

Sa feja, shpresa dhe dashuria janë të pranishme dhe vepruese në jetën tonë, si dëshmi për praninë dhe veprimin e Tij në ne dhe në botën e sotme?

Prej të rënit në dashuri te dashuria

■ SHKRUAN:
Mihály SZENTMÁRTONI

Ndonëse dashuria lajmërohet spontanisht, ajo në rrjedhën dhe zhvillimin e vet nuk guxon dhe s'mund t'i lëshohet spontanitetit. Njeriu është qenie e arsyeshme, prandaj çdo veprim dhe çdo marrëdhënie, që të jetë në mënyrë të vërtetë njerëzore, duhet të mbartë në vetvete vulën e kësaj arsyeje. Edhe në marrëdhënien dashurore të dy njerëzve duhet njohur disa ligjshmëri elementare të brendshme të dashurisë të nderohen e me vetëdije. Vetëm në atë mënyrë mund të rritet dashuria.

E ç është dashuria?

Anna A. Terruwe, mjeke dhe psikiatre holandeze, e definon dashurinë thjesht si „ndjenjë e dashamirësisë ndaj personit tjetër”. Ka diçka në këtë person që më pëlqen, që më tërheq, që më bën të ngjashëm me të. Jam i kthyer kah ai person. Me atë rast pak kanë rëndësi shkaqet për arsye të cilave më pëlqen ai - kjo mund të ndodh për shkak të shumicës së sendeve nga më të ndryshmet. Kryesore është se ka diçka në të që për mua domethënë një e mirë, kurse për qenien njerëzore natyrisht është që t'i mrekullohet së mirës.

Dashuria është ndjenjë, prandaj sipas natyrës së vet duket psikofizike. Kjo domethënë se e përfshin botën psikike të personit, por domosdo shfaqet edhe përgjatë. Ndjenja, sipas definicionit, është gjendje e tronditur e organizmit që shprehet në të përgjeturit psikik, sjellje emocionale dhe në ndryshimet fiziologjike. Natyrisht, dashuria nuk mund të shprehet vetëm në ndjenjë, por sipas fjalorit psikologjik - ajo është *qëndrim ndijesor*, d.m.th. gatishmëri e përhershme që ndaj personit tjetër të reagojë në mënyrë të caktuar. Kështu dashuria shprehet domosdo në sjellje dhe në cilindo aspekt tjetër të personit: në qëndrime, në lëvizje, në fjalë. Dashuria, pra, e ka aspektin e vet motorik, d.m.th. të shprehurit trupor. Mund të tregohet në të shikuar, në dridhjen e zërit, në fjalët që shqiptohen, në mënyrën e prekjeve. Gjithkund është e pranishme butësia.

Butësia është vështirë të definohet, mirëpo mund të përshkruhet. Ai që është i butë e shpreh tjetrit të dashur, të mirë, të përzemërt dhe të çmueshëm. Dashuria e bën të bukur atë që është e shëmtuar. Dashuria dëshiron ta pranojë personin të tillë siç është ajo/ ai sepse pikërisht pëlqehet si e/ i tillë. Prandaj është gjithmonë shenjë e keqe kur dikush hyn në martesë me një qëllim të fshehur ose madje të theksuar që tjetrit ta ndërrojë. Është shenjë e keqe, sepse domethënë se nuk e do per-



sonin konkret, të tillë siç është, por njëfarë projekcioni mbi të, një qenie të paramenduar, ndoshta ideale që nuk ekziston. Më tutje, ai që është i butë nuk merr asgjë për vetë. Nuk kërkon asgjë, thjesht është i lumtur në praninë e personit tjetër, të dashur. Dëshiron vetëm të jetë së bashku, nderon, kurrë nuk është agresiv.

Dashuria është bazë e tërë jetës psikike. Ajo është toni elementar që e siguron harmoninë e jetës ndijesore (emocionale). Prandaj është me dobi të analizohet më thellë ky aspekt materialo-trupor, sepse në të vërtetë në këtë fushë të rinjtë kanë më së shumti pyetje të hapura dhe në përgjithësi këtu zotëron peshëjellimi më i madh: çka guxojnë, deri ku guxojnë të shkojnë në shprehjet e dashurisë etj.? Aspekti trupor i dashurisë mund të shprehet në mënyra nga më të ndryshmet. Do t'i përmendim vetëm dy forma: të shikuarit dhe të prekurit.

“Syte janë pasqyra e shpirtit” - thotë urtia popullore. Sigurisht, jo pa bazë. Sytë më së shumti shprehin përjetimet intime, ndjenjat personale, siç na dëshmojnë hulumtimet në fushën e psikologjisë eksperimentale. Shikimi mund të jetë i pikëlluar, i gëzueshëm, agresiv, i shqetësuar, energjik, i entuziazmuar, i dyshuar etj. Në dashuri syri e pasqyron ngazëllimin pa sforcim. I tillë është shikimi i nënës për fëmijën, i djaloshtit për vajzën që e do. Këtë shikim e karakterizon qetësia pa dëshira. Shikimi krejtësisht i ndryshëm është kur diçka ose dikush dëshirohet: më nuk është i qetë në magjepsje, nuk është më i

pastër dhe i rehatshëm. Ai të cilit i është i drejtuar ai shikim me siguri këtë e ndjen.

Prekja është shprehja e dytë natyrore e jashtme e dashurisë. Kur dikë e duam, sipas vetë natyrës dëshirojmë ta prekim, ta ledhatojmë. Nëna e merr në prehrë fëmijën, mikut ia shtrëngojmë dorën ose ia rrahim krahët, djaloshti e përqafojnë vajzën, të dashuruarit mbahen për dore. Prekja si shenjë e dashurisë është shprehje origjinale e afektit. Shumë neuroza e kanë rrënjën në mungesën e butësisë së nënës, të ledhatimit trupor në fëmijërinë e hershme. Mënyra se si dashuria shprehet me prekje, është individuale. Për më tepër, ekzistojnë dallime ndërmjet djaloshtit dhe vajzës. Femrat në përgjithësi shprehin më spontanisht në prekje dhe e kanë nevojën më të madhe për prekje se sa meshkujt. Ai që është i butë kurrë nuk është agresiv. Shtrëngimi i përzemërt dhe i nxehtë i dorës mund të jetë i butë, kurse putja ose përqaftimi i flakët mund të ndikojë agresivisht.

Të rënë në dashuri vetë nuk mund të jetë bazë e lidhjes martesore. Atë duhet kuptuar vetëm si kapital fillestar, “pajë” e fituar, dhuratë e natyrës, në të cilën duhet ndërtuar, të cilën duhet pasuruar, të cilën duhet shndërruar në një dashuri më të ndryshme që mund të qëndrojë, që nuk është e lëshuar vetvetes, që nuk është më gjendje të cilës i jemi të lëshuar, por akt, veprim në të cilin jemi aktiv dhe bashkëpunëtorë të vetëdijshëm.

Urtia e thellë e gjuhës gjithash-

“Ndonëse dashuria lajmërohet spontanisht, ajo në rrjedhën dhe zhvillimin e vet nuk guxon dhe s'mund t'i lëshohet spontanitetit. Njeriu është qenie e arsyeshme, prandaj çdo veprim dhe çdo marrëdhënie, që të jetë në mënyrë të vërtetë njerëzore, duhet të mbartë në vetvete vulën e kësaj arsyeje.”

tu na vë në dukje dallimin më së të rëndësishëm ndërmjet të rënë në dashuri dhe dashurisë në lidhjen martesore. Njeriu „dashurohet”, mirëpo „lidh” ose „hyn” në martesë. Kjo domethënë se të rënë në dashuri është fat që ka, kurse lidhja martesore është arritje e bazuar në vendosmëri. Tragjike është nëse na tradhton dashuria, mirëpo në përgjithësi është faji i jonë nëse nuk kemi sukses në lidhjen martesore.

Secili dëshiron të ketë sukses në lidhje martesore. Prandaj është me rëndësi që të ndërtohet në themele të forta. Të rënë në dashuri nuk është e mjaftueshme. Kërkohet një dashuri e fortë, e vërtetë. Cilat janë shenjat e kësaj dashurie „të vërtetë”? Rëndom cekem këto katër shenja:

1. *Dashuria e vërtetë nuk është pasivitet, por aktivitet.* Kjo domethënë se kërkon mund dhe angazhim. Dashuria në të vërtetë është detyrë. Vetëm një dashuri e tillë aktive mund të jetë bazë e marrëdhënies martesore cilësore dhe jetëgjatë.

2. *Dashuria kërkon reciprocitet, dyansë.* Dashuria nuk është vetëm detyrë, ajo është edhe detyrë e përbashkët. Në atë kuptim dashuria është mbajtje e sistemit në të cilin gjenden ata të dy. Në mënyrë të përshtatshme argumenton Shvarc: Kur maskulli vendos të martohet, atëherë lidhja martesore bëhet detyrë që duhet kryer. Dhe tani lajmërohet diçka krejtësisht e re: burri dhe gruaja ndajnë përgjegjësinë ndaj martesës si të tillë, sikur, në procesin e vet, martesë të jetë bërë një tërësi e re, superindividuale që

e shtynë maskullin dhe femrën që të hyjnë në shërbesën e saj. Ai detyrim është vetëm atëherë i durueshëm nëse ata të dy vullnetarisht aspirojnë kah qëllimi i saj. Kjo në të vërtetë është përvojë që e përkrah dhe krijon një karakter të pashtatshëm të gjendjes së martesës.

3. *Dashurisë së vërtetë nuk i pengon veçantia dhe individualiteti i partnerëve.* Dashuria është lidhje (bashkim) i të qenit i ndryshëm, e jo shkatërrim i tij. Për këtë arsye është gjithmonë rrezik të hyhet në martesë edhe pse me qëllim të fshihet që partneri të ndryshojë. Ai, natyrisht, do të ndryshojë vetvetiu nën udhëheqjen e dashurisë, mirëpo kjo nuk është ndryshim i qëllimshëm, por spontan.

4. *Dashuria e vërtetë ndryshon vazhdimisht.* Nuk është e vrazhdë, por është fleksibile, për çdo ditë më e ndryshme, për çdo ditë e re. Për atë arsye duhet kultivuar vazhdimisht.

Vetëm një dashuri e tillë mund të jetë garanci e martesës së rregulluar. Këtë dashuri ndërmjet bashkëshortëve nuk mund ta zëvendësojë as dashuria ndaj fëmijëve. Për më tepër, dashuria cilësore e martesës është parakusht i dashurisë cilësore të prindërve. Me këtë vërtetë e kemi prekur detyrën thelbore edukative: edukimin për dashuri.

vijon

(Marrë nga libri: Mihály Szentmártoni, *Bota e të rinjve*. Përkthyer: P. Shtjefën Dodes SJ)

Zgjedhja e thirrjes - përcaktim për një jetë më të mirë

■ SHKRUAN:
m. Hana KQIRA

Si të bëhet zgjedhja sot, kur gjendemi në "kohën e zgjedhjeve" e ku tentohet të bëhen zgjedhje edhe të krijesave të paralindura që është vepra më e përkryer e Zotit. Pra, zgjedhjet sot janë të shumëfishuara, për atë edhe është shumë më vështirë të bëhet. Sepse zgjedhja sjell me vete një ekskluzivitet çka do të thotë: nëse zgjedh një gjë, nuk mundem në të njëjtën kohë të zgjedh edhe tjetrën. Kështu ndodh një lloj pakënaqësie, apo edhe dyshimi në personin që zgjedh. Mendojmë: ah, si ta kisha zgjedhur atë

i dërguar te vëllai njeri. Papa Benedikti i XVI në Porosinë e tij për ditën e XIV të lutjes për thirrje më 29 prill 2007 mes të tjerash thotë: Kujdesi për thirrje kërkon një edukim të vazhdueshëm të dëgjimit të zërit të Zotit, si e bëri edhe Helia që i ndihmoi Samuëlit të vogël të kuptojë dhe të jetë i gatshëm ta realizojë atë çka Zoti kërkon nga ai (cf. 1 Sam 3,9). Si e bënë zgjedhjen nxënësit e parë të Jezusit, peshkatarët e Galilisë, kur e takuan Jezusin dhe si lejuan të jenë të përfutur nga shikimi i Tij, nga zëri i Tij dhe pastaj e pranuan ftesën e Tij: Ejani pas meje! Thirrja është iniciativa e Atit që zgjedh në një akt të dashurisë kreative, personale dhe unike, në

2. Gjendja aktuale shoqërore-kulturore e të rinjve, në një situatë në ndërrime të vazhdueshme

Para pyetjes së një të riu/reje: a është i thirrur për martesë apo për jetën e kushtuar, mund të përgjigjet vetëm pas një procesi të kërimit dhe verifikimit. Në situatën aktuale të pluralizmit kulturor, edhe në shumëllojshmërinë e sistemeve të referimeve, bëhet gjithnjë e më e vështirë dhe problematike të kuptohet dhe akceptohet fare vlera e thirrjes dhe ideali për një thirrje, siç është ajo e jetës së kushtuar, apo, siç ndryshe quhet, ndjekjes së Jezusit në mënyrën radikale.

“ Kriza e kuptimit të jetës, humbja e vlerave dhe pluralizmi i zgjedhjeve ndikojnë rrënjësisht mbi zbulimin dhe zhvillimin e një thirrje, por gjithashtu edhe mbi projektet tjera njerëzore, të cilat paraqiten tek adoleshentët dhe të rinjtë të cilët shpeshherë bllokohen në zgjedhjet e tyre. ”

tjetrën, po ta kisha bërë A-në në vend të B-së.” Kështu, në brendinë e njeriut fillon të krijohet një lloj opozicioni, kundërshtimi. Pra, mundësia e të zgjedhurit ndikon në një mënyrë apo tjetër edhe në jetën tonë, në marrëdhëniet tona ndërmjet njerëzore. Pa marrë parasysh cila është zgjedhja jonë, ajo mund të ketë pasojë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte, disa zgjedhje mund të kenë pasojë për gjithë jetën edhe në atë të amshuar dhe disa të tjera mund të ndikojnë dhe ndikojnë edhe tek të tjerët. Njeriu është i fuar të ushtrojë lirinë e vet për përgjegjësi në çdo situatë jetësore: në shtëpi, në rrugë, me veten apo me të tjerët. Nevojitet gjithmonë të jetojmë si njerëz të rritur dhe të vetëdijshëm dhe të jemi përgjegjës për atë që jemi dhe dëshirojmë të veprojim. Njeriu është aq i lirë sa që mund ta keqpërdorë lirinë.

1. Zgjedhja për një jetë të kushtuar Zotit

Kur flasim për zgjedhjen, atëherë mendojmë në përgjithësi, por në këtë rast kemi fjalën për zgjedhjen e jetës së kushtuar apo meshtarisë.

Si të bëhet atëherë zgjedhja për një jetë të kushtuar? Njeriu jo vetëm se ka një thirrje, por në fakt ai vetë është thirrje. Thirrja ka në vetvete dy aspekte, atë të dialogut dhe të dinamizmit. Njeriu është i thirrur nga Zoti, por jo të mbetet aty, por është edhe i dërguar,

të cilën Zoti e thërrer njeriun me emër (cf. Iz. 43,1) sipas një projekti të planifikuar për të. Për këtë thirrja është një akt feje ku kërket nga personi që të kalojë (transhndodhet) deri në atë pikë që të zbulojë apo perceptojë vullnetin e Zotit dhe ta dëgjojë thirrjen dhe ta realizojë atë. Kërket nga personi që të ketë një miqësi intime dhe besim në Të që të pranojë të bashkëpunojë për shëlbimin e njerëzimit. Sepse thirrja nuk është kurrë një akt personal, por përfshin mbarë shoqërinë e ndoshta edhe njerëzimin. Pra, është e domosdoshme që personi të ketë një projekt jete që bashkon dhe orienton tërësinë e tij drejt Zotit dhe për përhapjen e Mbretërisë së qiellit në botë. Projekti është një proces, i cili arrihet gradualisht duke u zbuluar dhe përpunuar me zhvillimin e identitetit personal të kandidatit. Çdo thirrje arrin nëpërmes një bashkësie të besimtarëve-Kishës. Në Kishë ekzistojnë thirrje të ndryshme sipas Shën Palit, secilit iu është dhënë një «karizëm» dhuratë e veçantë, sipas lirisë së Zotit dhe kapacitetit të njeriut, por jo për veti, por për të ndërthurur Trupin Mistik të Krishtit, popullin meshtarak, profetik dhe mbretëror për të vepruar për drejtësi dhe paqe, për shëlbimin e botës dhe bashkimin tonë me Zotin. Pastaj është me rëndësi që personi të ketë një dinamizëm afektiv të dashurisë e të shërbimit në CARITAS.

Kriza e kuptimit të jetës, humbja e vlerave dhe pluralizmi i zgjedhjeve, ndikojnë rrënjësisht mbi zbulimin dhe zhvillimin e një thirrje, por gjithashtu edhe mbi projektet tjera njerëzore, të cilat paraqiten tek adoleshentët dhe të rinjtë dhe të cilët shpeshherë bllokohen në zgjedhjet e tyre.

Për zhvillimin dhe rritjen e një thirrjeje, ne duhet të kemi parasysh situatën kulturore, shoqërore, politike si dhe religjioze të një vendi dhe një populli, sepse ato bëhen «toka ku bie farat», ku thirrja lind dhe zhvillohet.

Një kulturë me ndërrime të mëdha dhe të shpejta dhe rrënjësore, luan rolin, mos të them, gati përcaktues të një zgjedhjeje për një thirrje. Të gjitha fenomenet tjera kulturore si p.sh. tek ne e kaluara me një sistem të ashpër ateist dhe komunist, pastaj në nivelin botëror si: globalizimi, neoliberalizmi dhe «new economy», krijojnë një panoramë problematike kulturore, e cila ndikon jo vetëm në zgjedhjet e të rinjve, por edhe në edukimin dhe formimin e tyre personal. (Cf. DEL CORE Pina, Identità, cultura e vocazione, Percorsi di formazione e di riappropriazione/2, in Vita Consacrata 39 (2003) 4, 381).

Shoqëria aktuale përkujdeset më shumë që shoqëria dhe puna e tyre të jetë efikase dhe prodhimprurëse, se sa të formojë apo të investojë në edukimin e gjeneratave të reja dhe të përkujdeset në



globale, integrale dhe të shëndoshë. Sepse formimi, siç thotë edhe Papa Gjon Pali II, duhet të arrijë personin në tërësinë e tij (cf. VC 65). Formimi duhet të jetë proces i unifikimit dhe harmonizimit të marrëdhënieve me veten, me të tjerët dhe me Zotin. Sepse thirrja përshkon personin në përgjithësi, shpirtin dhe trupin, si maskullin ashtu edhe femrën në vetën personale dhe unike dhe të papërsëritshme. (cf. PI 9).

Për këtë arsye, mendoj se është e lejuar të pyesim, si të rinjtë tanë ballafaqohen me realitetin shoqëror, kulturor, zhvillimin teknologjik e mënyrat e reja të të shprehurit, apo të komunikimit, me botën virtuale dhe të marrëdhënieve ndërmjet njerëzore interkontinentale. Ky është një ndryshim i madh nga e kaluara, për të cilën ne të rriturit shpeshherë nuk kemi një njohuri e as përvojë. Pra, si kuptohet sot zgjedhja, me çfarë logjike dhe si arrihet fare deri të vendimi i një zgjedhjeje. Si pranojmë ajo dhe si përpunojmë në jetë dhe në situatë të ndryshme jetësore? Të gjitha këto sfida që rrjedhin nga kultura aktuale, nuk guxojmë t'i nënvlerësojmë. Sepse kultura është pjesë përbërëse e jetës dhe formimit të identitetit personal dhe shoqëror, në të cilët një zgjedhje bëhet apo edhe ndërrim apo nuk ndërrim fare, sepse është e kushtëzuar nga stillet e ndryshme jetësore dhe kulture, nga idetë dhe mentaliteti i një kulture. Në këtë shoqëri të kompleksuar e aq të ndryshme

e dinamike dhe multi-kulturore kemi vështirësi të gjejmë koordinatat dhe të kuptojmë jetën tonë dhe efektin që i bëjnë disa transformime aq të shpejta, të cilat depërtojnë thellë në disa aspekte delikate dhe domethënëse të jetës sonë njerëzore dhe të krishterë (Cf. DE PIERI Severino, Il discernimento vocazionale. Criteri di idoneità e controindicazione, in COSPES (a cura di), Difficoltà e crisi nella vita consacrata (Coordinamento di DEL CORE Pina), Torino-Leumann, Elle Di Ci, 1996, 93).

Zgjedhja dhe ndërrimet zhvillohen në të njëjtën kohë kur edhe pjekuria personale, edhe zgjedhja pra, varet rrënjësisht nga kultura ku personi jeton. Sepse zgjedhja bëhet në kohë dhe hapësirë, pra konkretizohet në një kontekst të marrëdhënieve. Apeli apo thirrja arrin normalisht nëpërmjet ndërmjetësuesve si individualisht dhe shoqëror apo bashkëkohor. “Sepse çdo jetë është efektive në një takim, sepse njeriu bëhet Unë vetëm në Ti” (BUBER Martin, Il principio dialogico, Milano, Edizione Comunità, 1959, 30).

Personi bëhet i tillë, apo njihet si person vetëm duke dialoguar dhe duke hyrë në marrëdhënie me tjetrin. Për atë është shumë me rëndësi baritorja e të rinjve, baritorja e thirrjes, animimi i thirrjeve, orientimi i thirrjeve, baritorja familjare, udhëheqja shpirtërore etj.

(Vijon)

Domethënia e disa simboleve (e përgatitur enkas për fëmijë)

UJI

Sa herë të kanë thënë se uji është pasuria më e çmuar e planetit tonë! Aq i vlershëm sa të jetë vellai ynë (it. Acqua gj. f. motër), kështu e quante edhe Shën Frani i Asizit. Jo vetëm por: "uji është i dobishëm, i çmueshëm dhe i pastër si loti".

Pa ujë, nuk do të kishte kurrfarë mundësie të jetesës mbi tokë. Kur shiu vonon me muaj të tërë, menjëherë fusha e ndien nevojën, ja edhe brengat e bujqve. Kjo të bënë të kuptosh sa është i rëndësishëm dhe sa shumë është konsideruar elementi i ujit në të gjithë popujt e në të gjitha religjionet.

Provo të meditoth duke u nisur prej përdorimit të përditshëm të këtij elementi. Zgjoresh në mëngjes e pastrohesh. E nëse gjatë ditës, deri sa luan, të ndodh të pastrosht duart, e sidomos para se të ulesh në tryezë. Ja pra njëra nga shumë doli të ujit: uji shërben për t'u larë e për t'u pastruar.

Nga këtu rrjedh simbolizmi më i afërt. Përveç trupit, ti ke edhe shpirtin. Sikur trupi edhe shpirti mund të njolloset. Edhe shpirti ka nevojë për pastrim. Ja edhe arsyeja pse uji është bërë, qysh në kohët më të lashta shenjë e pastërtisë së brendshme.

Zhytja në ujë – në Gang të Indisë, apo në lumin Nil për egjiptasit, apo në Jordan për hebrejtë, çfarë kuptimi ka? Përgjigja është e thjeshtë për faljen e mëkateve dhe shenjtërinë e brendshme.

Në shoqëri të ndryshme, ndër të cilët popullin i Izraelit, mund të gesh vendin e larjes apo të pastrimit në fillim të tempullit apo para momentit të lutjes. Në lidhje me këtë duhet të lexosh kapitujt

11-16 të librit të Kishtarit. Një gjë duhet sqaruar: larja e duarve para ushqimit dhe para lutjes nuk ishte një gjë vetëm higjienike, por ma shumë një pastrim shpirtëror i brendshëm.

Pra, posa zgjoresh në mëngjes, pastrohesh. Por uji të shërben edhe për gjëra tjera. Një prej tyre është edhe për të shuar etjen. Pirja e ujit është një gjë elementare dhe shumë e domosdoshme për trupin tënd, sepse trupi yt ka nevojë vazhdimisht për një sasi të ujit të caktuar. Prandaj uji e mundëson gjallërinë e trupit tënd. Nga këtu edhe një simbolikë tjetër më shumë rëndësi. Uji shpreh dëshirën më të thella njerëzore: lumturinë, lirinë, dashurinë, të vërtetën. Si mos të kujtojmë bisedën e Jezusit me Samaritanën (shiko Gjn 4, 1-5)? Ndërsa gruaja flet për ujin natyror, Jezusi flet për një ujë tjetër, më të gjallë, për Hirin. Shën Gjoni do të thotë me një theks të veçantë që uji është Shpirti Shenjt (Gjn 7, 37-39).

E di që më nuk po të pritët të më thuash se uji ka edhe një efekt tjetër. I ke sigurisht para syve të tu shumë katastrofa që kanë qenë shkak i shumë vdekjeve. Uji, vërtet është edhe vdekjeprurës. Por dëshiroj të shtyj mendjen tënde jashtë aspektit negativ të vdekjes. Mendo për një cast dhe përgjigju pyetjeve të mia: Zot, po mos t'i kishte fundosur në detin e kuq ushtarët egjiptas, hebrejtë a do të kishin shpëtuar? Një pyetje tjetër: vëshimi biblik që i ka shkatërruar të këqijtë, a nuk i ka dhënë ndoshta një fillim të ri njerëzimit në Noen e drejtë dhe të bijve të tij. Sikur po e sheh, uji mund të jetë mjet i vdekjes, por edhe mjet i shpëtimit. Gjithë këtë që po ta them, nëse dëshiron të kuptosh sakramentin e pagëzimit,

ku është i pranishëm ky aspekt i dyfishtë: vdekje (në mëkat) dhe ringjallja (në Hirin e Zotit).

Ti e di se uji është pjesë e domosdoshme e rritit të pagëzimit. Në shekujt e parë të krishterimit, të rriturit pagëzoheshin në ujë të rrjedhshëm. Zhytja në ujë i ka dhënë zanafillën edhe vetë falës pagëzim që prej greqishtes do të thotë zhytje. Më pastaj u ndërtuan Kisha dhe pagëzimet (Baptister), e sidomos pas shekullit V, kur erdhi edhe përdorimi i pagëzimit të foshnjave, kështu që u pëlqye më shumë riti i "larjes" me ujë, se sa ai i "zhytjes". Aktualisht riti i pagëzimit ia ofron mundësinë meshtarit të zgjedhë zhytjen apo vetëm larjen e kokës pakëz me ujë.

Të kthehemi tek mesha e shenjte: ku e sheh përdorimin e ujit? Pas paraqitjes së dhuratave, meshtari i pastros duart. Pse? Në antikitet ishte një nevojë e higjienës: dhuratat që shpesh përbeheshin edhe prej produkteve natyrore, mund t'i ndotnin edhe duart e meshtarit. Por megjithatë, gjesti përmbante edhe një domethënie rituale.

Do të pyesësh vetveten edhe për arsyen që meshtari i vë disa pika të ujit në këlkun me verë rrushi. Kuptimet mund të jenë edhe të ndryshme, por unë do të ndalem vetëm te kësaj: ajo simbolikë paraqet bashkimin në mes të njeriut besimtar (ujit) dhe Krishtit (vera) kujtimi i vdekjes së tij.

Nëse e ke kuptuar domethënien simbolike të ujit, sidomos në pagëzim, atëherë e me ke edhe më lehtë të kuptosh edhe kuptimin e ujit të bekuar. Në fillim të meshës, sidomos në disa kohë të veçanta apo të forta (kreshmët) meshtari me ujë të bekuar e stërpik

popullin, sikur dëshiron të thotë: kujtoje pagëzimin tënd. Ky rit përbën apo e zëvendëson traditën e moçme të Kishës së parë që në hyrje të Kishës lanin duart për kremtimin e meshës shenjte. Më gjithë atë ka mbetur akoma tradita deri më sot shumë e mirë që të shënohemi me ujë të bekuar para se të hyjmë në Kishë.

Por thirrjen më të madhe në pagëzim e gjejmë në vigjiljen e Pashkëve të Shtunës së Madhe (në të kaluarën ishte i vetmi moment gjatë tërë vitit që administrohej pagëzimi). Meshtari prijës e bekon ujin e burimit pagëzimor. E kemi edhe një thirrje tjetër në pagëzim: bekimi i shtëpive me ujë (gjatë kohës së ardhjes në ritin ambrozian, ndërsa në kohën e Pashkëve në ritin romak).

Nëse ke marrë pjesë ndonjëherë në ndonjë rit salikimi e ke parë patjetër meshtarin që e stërpik kufomën në momente të ndryshme të kremtimit: në shtëpinë e të vdekurit, në fillim të meshës, dhe tek varrezat. Liturgia e Kishës, dëshiron të nënvizojë karakterin pagëzimor e pashkvor të vdekjes së një të krishterit.

Edhe larja e këmbëve meriton një shpjegim të veçantë. Jemi në të Enjten e Madhe: riti kremtohet në pasditen e vonshme, gjatë ose menjëherë pas meshës "In Coena Domini", e quajtur kështu, sepse përkujton darkën e fundit të Jezut Krishtit. Meshtari e merr një legen, pak ujë dhe filloi t'i lajë këmbët, pastaj ua u fshin atyre duke e emittuar tërësisht gjestin që e ka bërë Jezusi gjatë darkës së fundit me apostujt (shiko Gjn 13,1-20). Ke për ta pyetur veten: cila është domethënia e këtij gjesti? Një hyrje të shkurtër. Tek hebrejtë larja e këmbëve ishte një vepër nikoqire e sidomos në

ambientet e tyre ku rrugët ishin përplot me pluhur. Pa e theksuar fare se kjo ishte edhe një detyrë e shërbëtorëve, megjithatë ky lloji shërbimi kishte edhe domethënie në nënshtrimit dhe të përvujtërit. Ja pse edhe ky gjest gjen kundërshtim edhe kryepostullin Pjetër.

Padyshim që Jezusi dëshiroi të na dërgojë një mësim mbi shërbimin. Vazhdimisht kishte thënë se kishte ardhur për të shërbyer e jo për të qenë i shërbyer. Tregimi i Shën Gjoni pikërisht përfundon edhe me këtë urdhër: "Edhe ju duhet t'ia lani këmbët njëri tjetrit".

Po të jap edhe një ndihmë tjetër: kuptimi i plotë dhe i thellë i larjes së këmbëve e gjen në kontekstin në të cilin ndodh. Është mbremje; Jezusi, në darkën më të rëndësishme të historisë botërore, dhe kjo darkë i paraprin vdekjes së ringjalljes së tij. Pra larja e këmbëve mëton të shpjegon kuptimin e mundimeve dhe të vdekjes së Jezut Krishtit. Jezus Krishti në kryq nuk zhveshet vetëm nga rrobat e veta, por edhe nga vetë jeta e tij tokësore.

Larja e këmbëve në Kishë ka marrë edhe kuptime tjera. Një ndërlidhje e ka, sipas disave, me pagëzimin, një tjetër me dashurinë vëllazërore. Fillimisht në disa kisha larja e këmbëve bëhej vetëm të shtunës e madhe gjatë vigjiljes së Pashkëve. Por duhet të pranojmë që një traditë e tillë nuk pati pranim të madh dhe sukses të veçantë. Përparësi pati sidomos kuptimi i shërbimit dhe i përvujtërisë nga ana e Jezusit. Larja e këmbëve u përhap sidomos në ambientet e murgjive, si shenjë e pranimit ndaj shtetgarëve, por edhe si shërbim reciprok në vetë bashkësinë.

DRITA

Ke vërejtur patjetër, sapo ke hyrë në ndonjë kishë, një llambë apo dritëz të kuqe afër altarit. Kjo dritëz qëndron e ndezur natë e ditë, për të treguar që aty, në Tabernakull, është vërtet i pranishëm Miku më i madh ynë, Jezusi, që është definuar vetë "Drita e Botës".

Drita është një simbol tjetër, një ndër simbole më të dalluar për të treguar vetë Zotin. Kur mendon në dritë, nuk mund të mos mendosh në diell. E pikërisht dielli, qysh prej kohërave më të hershme të krishterimit, ishte dhe është bërë simbol i Krishtit. Edhe për këtë që Krishtindjet festohen më 25 dhjetor: Kisha e parë ka dëshiruar të "kristianizojë" një festë pagane në nder të diellit të pamposhtur, për t'ia shpallur mbarë botës se Dielli i pambarim është pikërisht Ai, Jezusi i ringjallur.

Ti e di se dielli e largon terrin e

natës: e shpall një ditë të re. Qysh prej kohërave më të vjetra drita ka qenë simbol i botës hyjnore, që vazhdimisht është sulmuar e kërcënuar prej botës më të dobët - fuqije të territ.

Shën Gjoni në ungjillin e tij, i vë vazhdimisht në kundërshtim dritën dhe terrin, ku drita qëndron përkrah të mirës, ndërsa terri përkrah të keqes. A të kujtohet shërimi i një të verbi të lindur dhe kundërshtimet e hebrejve (shiko Gjn 9, 1-47). Pikërisht gjatë një feste të hebrejve - festa e dritës - Jezusi kishte deklaruar "unë jam drita e botës: kush më ndjek mua nuk do të mbetesh në errësirë, por do të ketë dritën e jetës" (Gjn 8,12).

Ti e di që pa dritën e diellit, jeta në tokë do të ishte e pamundur. Kuptojtë tani pse edhe Bibla hapet me dritën e krijuar prej Zotit, si fillim i çdo jete. E përfundon (faqja e fundit e zbulesës) me premtimin solemn që qyteti i ri Jeruzalemi qiellor, nuk do të ketë

më nevojë as për dritën e diellit e as për ndonjë dritë tjetër, "sepse do të ndriqojë lavdia e Hyjit dhe lama e tij do të jetë gengji...aty nuk do të ketë errësirë". Deri tani të kam folur për dritën e diellit, por nuk është ajo e vetmja dritë.

Përveç dritëzës së kuqe të shejtnshueshmisë sakrament, po t'i kujtoj edhe disa drita të tjera. Ke marrë pjesë domosdoshmërisht në ndonjë procesion me rastin e ndonjë feste mariane apo të ndonjë feste tjetër, si në procesionet e "aux flambeaux". Ndoshta edhe ti ke pasur rastin të ndezësh një qiri të vogël para Zojes së Bekuar.

Një qiri që ndizet flakë! Nuk të thotë asgjë! Është e vërtetë: në shoqërinë tonë me shumë dritëza artificiale, ka humbur gradualisht edhe kuptimi i llambave. Kohë më parë ato shkonin apo ndizeshin me vaj. Megjithatë, qiri mban në vete domethënie të ndryshme dhe akoma të vlefshme. Provo të shikosh me kujdes një qiri të ndezur: ai qiri e largon terrin dhe

krijon një lloji atmosfere, sidomos nëse Kisha është nën hije. E ndërsa përhap edhe nxehtësi edhe dritë, e sheh se dalëngadalë edhe konsumohet. Mund të jetë një simbolikë e kohës që kalon, por edhe e jetës sonë, kur ajo konsumohet për të tjerët, duke shpërndarë dashuri dhe të vërtetë. Por ka edhe diçka edhe më tepër: a mendon ndonjëherë në fenë, e cila e ka shtyrë personin të ndezë atë qiri. Pse e ka bërë atë? Sa vuajtje prapa një qiri të ndezur. Nëse merr pjesë në një meshe solemne dhe e sheh altarin e madh krejt të ndriqur, e nëse je edhe ministar, patjetër e ke shoqëruar edhe meshtarin e me shandanët gjatë shpalljes së ungjillit.

Prej të gjithë qirinve, njërin nuk mund ta harrosh asesi: është qiri më i madhi, i vendosur mbi një mbajtëse, i ngritur afër altarit të pagëzimores. Ky është Qiriu i Pashkëve. Ndizet gjatë natës së Pashkëve. Është simbol i Krishtit të ringjallur, dritës së

botës mbarë. Qëndron afër altarit gjatë kohës së Pashkëve. Ndizet si zakonisht edhe gjatë pagëzimit të fëmijëve: prej flakës së tij babai i fëmijës së pagëzuar ndez qirin si shenjë e fesë dhe besimit në Jezusin. Po i njëjti Qiri i Pashkëve vendoset edhe afër kufomës gjatë rritit të salikimit, si shenjë e ringjalljes dhe e fitores së Krishtit mbi vdekjen.

Në kohët e lashta përdorej varja e dritëzave në varreza dhe kishin kuptimin e largimit të shpirtit të këqij. Për ne të krishterët dritëzat para dhe mbi varre tregojnë priten e Krishtit, shpresën në ringjallje dhe fenë në jetën e pasuros.

A e di që ekziston një festë më 2 shkurt ku bëhet edhe bekimi i qirinjve? E besimtarët marrin më vete në shtëpi qirinjtë e ndezur, jo edhe atë që kujtim, por si detyrë apo angazhim, me vullnet dhe dëshirë që t'u përngajnë virgjerave të urta e jo atyre marroqe të mbetura pa vaj (Mt 25, 1-13).



Ti që e do Nënë Terezën dhe ndërtimin e Katedrales, uroje, ndihmoje, realizoje, duke thirrur në numrin

0900-901-101

Çdo thirrje e jote të kushton një euro.

**TA NDIHMOJMË
NDËRTIMIN E KATEDRALES**

*Jam mik i Kishës Katolike
dhe dua ta ndihmoj
ndërtimin e Katedrales
"Nëna Terezë" në Prishtinë!*

Gjithë juve miq dhe bamirës
të dashur, ju mundësojmë ta
jepni kontributin përmes
xhirollogarive bankare.

Faleminderit!

X Raiffeisen BANK
Kosovo J.S.C.
Prishtina, Kosovo
SWIFT code: RBKORS22

**Adm. Ap. e Prizrenit
Numri i llogarisë:**
EUR: 1501 090000 1990 20
USD: 1501 090000 3765 30
CHF: 1501 090000 3764 33

Valuta	Banka	Shteti	SWIFT/BIC
EUR	Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG	Vienna, Austria	RZBAATWW
USD	American Express Bank, LTD	New York, US	AEIBUS33
CHF	UBS AG	Zurich, CH	UBSWCHZH80A

ABONONI "DRITËN"

Tash mund të jeni abonues të revistës kulturore të Kishës Katolike në Kosovë "Drita". Për vetëm 12 euro në vit (ose 1 euro për secilin numër), ne do t'ju dërgojmë **me postë "Dritën"** (vetëm brenda territorit të Kosovës).

Plotësoni formularin e mëposhtëm, dhe na e dërgoni bashkë me vërtetimin e pagesës në adresën tonë:
Rr. Gjon Pali II 1, 20000 Prizren.

Emri: _____
Mbiemri: _____
Adresa: _____
Qyteti: _____
Kodi postar: _____
Numri i telefonit: _____
E-mail: _____

Pagesa prej 12 eurosh mund të deponohet në Raiffeisen Bank Kosovo, në llogarinë 1502 0310 0086 0188. Ju lutemi, mos harroni ta futni fletëdeponimin në zarf bashkë me këtë formular. Ju faleminderit!

Për informata më të hollësishme, ju lutemi të na kontaktoni në numrin e telefonit: 029 241 933/14, me faks: 029 241 232 ose me email: revistadrita@hotmail.com ose revistadrita@yahoo.com.

DRITA

E PËRNUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE
Prizren • Shkronja e vitit XXVI • Nr. 4 (174) • Qyteti: Prizren • Rr. Gjon Pali II, 1 • 20000 Prizren, SHBA

Feja – kërkim, shpresa – veprim, dashuria – flijim dhe dhurim

Feja – kërkim, shpresa – veprim, dashuria – flijim dhe dhurim

Feja – kërkim, shpresa – veprim, dashuria – flijim dhe dhurim

Muzika shqiptare
(veçitërin i shkurtër)

Muzika shqiptare
(veçitërin i shkurtër)

Muzika shqiptare
(veçitërin i shkurtër)